

FINANCAT LOKALE
LOCAL FINANCES | Strengthening
Local
Government
PFM

Efekti i COVID 19 në Financat e Vetëqeverisjes Vendore në Shqipëri

Nëntor 2021



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Ky Raport është përgatitur nga Ekipi i Projektit “Financat Lokale”. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet në Raport nuk shprehin domosdoshmërisht opinionin e Qeverisë Zvicerane ose Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

FINANCAT LOKALE | Strengthening
LOCAL FINANCES | Local
Government
PFM

PËRMBAJTJA

1.	PËRMBLEDHËSE.....	4
2.	HYRJE	8
3.	MASAT E MARRA NGA QEVERIA QËNDRORE.....	8
4.	EFEKTET EKONOMIKE DHE SOCIALE TË PANDEMISË NË TREGUESIT KRYESOR MAKROEKONOMIK.....	9
5.	RISHIKIMI I BUXHETIT TË VITIT 2020	13
6.	EFEKTET E PANDEMISË NË NIVEL TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE	15
7.	EFEKTET EKONOMIKE SI PASOJË E COVID 19	16
8.	EFEKTET SOCIALE SI PASOJË E COVID 19.....	20
9.	RRITJA E ÇMIMEVE SI PASOJË E COVID 19	21
10.	RRITJA E SHPENZIMEVE TË SHËNDETIT SI PASOJË E COVID 19	22
11.	NDIHMA EKONOMIKE.....	23
12.	RISHIKIMI I BUXHETEVE VENDORE	25
13.	EFEKTET FISKALE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE SI PASOJË E COVID 19	25
14.	TKURRJA E TË ARDHURAVE TË VETA NË RAPORT ME BUXHETIN E MIRATUAR DHE VITIN FISKAL 201927	
15.	IMPAKTI NË TË ARDHURAT E VETA SIPAS ZËRAVE	28
15.1	TË ARDHURAT E VETA TË PUSHTETIT LOKAL	29
15.2	TË ARDHURAT TATIMORE NGA TAKSAT DHE TARIFAT	29
15.3	TË ARDHURAT LOKALE NGA TAKSAT DHE TARIFAT LOKALE	30
15.4	EFEKTI I ULJES SË TË ARDHURAVE TË VETA ËSHTË I DIFERENCUAR NDËRMJET QARQEVE	31
15.5	EFEKTI I ULJES SË TË ARDHURAVE TË VETA ËSHTË SHUMË MË I DIFERENCUAR NDËRMJET BASHKIVE.....	33
16.	BURIMET E FINANCIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE NË VITIN 2020	40
17.	EFEKTI MBI SHPENZIMET E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE	44
18.	ANALIZA E SHPENZIMEVE FUNKSIONALE	50
19.	KONKLUZIONE.....	51
20.	ANEKSI 1 - TË ARDHURAT TOTALE NË NIVEL TË BASHKIVE	56
21.	ANEKSI 2 - ANALIZA E SHPENZIMEVE NË NIVEL TË BASHKIVE	94

1. Përmbledhëse

Edhe pse niveli i reagimit dhe gatishmëria e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore ndaj pandemisë ishte e lavdërueshme, përgatitja për të përballuar situata të tilla emergjente ngelet e ulët për shkak të se NJVV-te kanë burime të limituara dhe struktura të dobëta institucionale të mbrojtjes civile, e nuk kanë strategji të përpunuar të mbrojtjes ndaj rrezikut nga fatkeqësitë. Krahas shtrëngimit të masave të kontrollit të miratuara në nivel qendror, bashkitë u përballën me nevojën për të përshtatur proceset e tyre në ofrimin e shërbimeve lokale, dhe reagimin e menjëhershëm ndaj urgjencës shëndetësore, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

Pandemia globale COVID-19 ndërpreu aktivitetin ekonomik duke e futur edhe Shqipërinë në recession per vitin 2020. Aktiviteti ekonomik në vend u tkurr me 3.85% dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.8%. Rënia ekonomike tkurri të ardhurat fiskale, të cilat të kombinuara me rritjen e shpenzimeve, sollën rritjen e deficitit fiskal. Shpenzimet publike u rritën në 33.4% dhe të ardhurat ranë në 26.5% të PBB. Deficiti fiskal arriti në 6.9% të PBB-së, ndërsa bilanci primar nga një nivel pozitiv në periudhën 2016 - 2019, u kthye në një nivel negativ në -4.7% të PBB. Raporti i borxhit publik ndaj PBB arriti në 77.9% të PBB-së në fund të vitit 2020, nga 66.3% në fund të vitit 2019.

Efektet fiskale të drejtpërdrejta për shkak të përkeqësimit të situatës ekonomike si në nivelin qendror por dhe vendor u shoqërua me rishikimin buxhetit dhe paketave fiskale. Në nivel qendror ndryshimi i buxhetit u reflektua në uljen e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve. Të ardhurat e 2020 u rishikuan me një rënie nominale prej 21.6% krahasuar me buxhetin e miratuar. Shpenzimet publike u rritën në 5.5% kryesisht për shkak të masave stimuluese të miratuara për të lehtësuar ndikimin në ekonomi të shkaktuar nga pandemia. Bashkitë e rishikuan buxhetin e tyre vendor duke ulur në mënyrë të ndjeshme pritshmërinë e realizimit të të ardhurave të veta. Ulja e buxhetit vendor krahasuar me buxhetin fillestar është -7.4%. Buxheti vendor rishikohet në ulje në 53.49 miliard lekë dhe përfundimisht në 53.28 miliard lekë nga 57.55 miliard lekë i miratuar fillimisht. Të ardhurat tatimore rishikohen në ulje në -14.4%, të ardhurat jo tatimore në ulje në -3.4% dhe financimi i huaj në -47%. Ndërsa transfertat e kushtëzuara rishikohet në një rritje të lehtë në +0.4%, dhe taksat e ndara në +33.3%. Ndryshimet fiskale u lidhën kryesisht me përjashtimet nga taksat e ndryshme të disa kategorive si personat me aftësi të kufizuara, nga ulja e tarifave lokale si ajo e zënies së hapësirës publike për muajt e emergjencës, tarifave të shërbimeve publike si ndriçimi, pastrimi dhe gjelbërimi, shtyrja e pagesave për taksat dhe tarifave vendore.

Masat fiskale patën efekte direkte në uljen e të ardhurave të bashkive. Tkurrja e të ardhurave është kryesisht nga ulja e shkallës së mbledhjes së të ardhurave të taksave e tarifave lokale, si dhe në një masë më të ulët nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme. Në krahasim me planifikimin e buxhetit, niveli mesatar i mbledhjes së të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore rezultoi 81.2% ose me një tkurrje në -18.8%. Ndërsa në krahasim me të ardhurat tatimore të mbledhura në vitin 2019, të ardhurat në vitin 2020 janë rreth -5.5 përqind më të ulta se në vitin 2019, ose pothuajse në një nivel me vitin 2018. Të ardhurat nga taksat lokale ranë me -22.4%. Të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme patën një

rënie në -4.3%. Gjithashtu një tkurrje të lartë patën dhe të ardhurat jotatimore në -22.4%. Gjithashtu të ardhurat jotatimore treguan një ulje në -4.9%.

Të ardhurat vendore në një masë të konsiderueshme u prekën ndjeshëm nga rënia e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Të gjitha kategoritë e të ardhurave kanë pësuar ulje në vitin 2020, përveç tarifës së pastrimit dhe të higjenës që ka treguar një rritje të lehtë në 0.3%. Taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë peshën më të madhe të grupit të taksave lokale ka shënuar një ulje në -5.9%, taksa e tabelës në -3.1%, taksat vendore të përkohëshme në -7.7%, taksat e tjera në -6.2%, tarifatat vendore për zënie e hapësirës publike në -20.8%, tarifatat e gjelbërimit në -9.1%. Taksa që ka rënie më të lartë është taksa e fjetjes në hotel, e cila ka shënuar një rënie në 96%.

Ndryshimi i të ardhurave të veta në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është i diferencuar ndërmjet Qarqeve. Qarqet me uljen më të lartë të të ardhurave janë qarku i Durrësit, Lezhës, Korçës, Dibrës dhe i Fierit. Qarqet me rritje të të ardhurave të veta janë ata të Kukësit dhe Vlorës. Rënie më të lartë të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e kanë qarku i Lezhës në -89.2%, qarku i Beratit -55.1%, qarku i Dibrës në -50.3%, qarku i Kukësit në -47.6%, qarku i Durrësit në -32.7%, dhe qarku i Elbasanit në -21.3%.

Ndryshimi i të ardhurave të veta të bashkive, në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, është më shumë i diferencuar ndërmjet vetë bashkive. Përqindja mesatare e uljes së të ardhurave është -19.7%. Të ardhurat tatimore e tarifore janë ulur në 33 bashki me një mesatare të uljes në -20%. Në rreth 43% e bashkive kanë një ulje të të ardhurave tatimore nga -20% deri në mbi -40%. Të ardhurat jo tatimore janë ulur në 32 bashki me një mesatare në -29.1%. Ndërsa janë rreth 25% e bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore në intervalin -20% deri në -40%. Numri i bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore mbi 40% është më i madh se në rastin e të ardhurave tatimore.

Pavarësisht përdorimit të fondeve të emergjencës, të kontributeve nga qeveria dhe nga donatorët, burimi total i financimit i bashkive në 2020 mbetet ndjeshëm më i ulët se viti 2019. Në vitin 2020 totali i burimeve të financimit është 4.6 miliard lekë më i ulët ose -8.2% krahasuar me vitin 2019. Të ardhurat e veta në ulje në -5.6%, financimi i huaj me i ulët në -77.2%, dhe transferta e pakushtëzuar e përdorur mbetet më ulët në -6.7%. Gjithësesi transferta e pakushtëzuar e miratuar në buxhetin vendor të vitit 2020 mbetet e pa përdorur plotësisht¹. Përveç efektit negativ në nivel agregat dhe vjetor, njesitë e vetëqeverisjes vendore kanë pasur mangësi të likuiditetit gjatë vitit fiskal, në veçanti në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit.

Shpenzimet totale në nivel agregat të njësive të vetëqeverisjes vendore u tkurrën në vitin 2020 në raport me vitin 2019 në rreth 4.6 miliard lekë, ose në -8.1%. Sipas kategorive ekonomike ndryshimi mbetet i diferencuar. Shpenzimet e personelit janë rritur në 2.5%, shpenzimet korente janë ulur në -1.1%. Tkurrjen më të lartë e kanë pasur shpenzimet kapitale

¹ Një nga arsytet e mos përdorimit të transfertës së pakushtëzuar sektoriale mbetet pamundësia e rialokimit të saj ndërmjet funksioneve. Për shkak të mbylljes administrative institucionet e arsimit parashkollor dhe parauniversitar, të konvikteve, një pjesë e shpenzimeve të planifikuara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale nuk e kanë realizuar duke mbetur një pjesë e fondeve pa u përdorur. Bashkitë nuk e kanë të lejuar të rialokojnë këto fonde në kategori të tjera sektoriale të nevojshme.

në -27.8%. Ecuria e shpenzimeve kapitale ka përcaktuar dhe dinamikën e shpenzimeve totale. Një efekt me ndikime shtesë ekonomike është dhe riallokimi i shpenzimeve kryesisht kapitale në shpenzime personeli apo operative, për të përballuar financimin e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen ndaj pandemisë si dhe mbështetjen e grupeve në nevojë.

Dinamika e shpenzimeve është e diferencuar si në nivel të qarkut për shpenzimet totale dhe sipas kategorive ekonomike. Shpenzimet totale janë ulur në të gjitha qarqet, me përjashtim të qarkut të Elbasanit. Shpenzimet kapitale janë ulur në të gjitha qarqet, kryesisht nga riallokimi në tyre në shpenzimet e personelit dhe ato operative. Qarku i Tiranës, i Elbasanit dhe i Korçës kanë riallokuar shpenzimet kapitale në shpenzimet e personelit dhe operative, duke siguruar një rritje positive të këtyre kategorive të shpenzimeve. Qarqet e tjera, pavarësisht riallokimit të shpenzimeve kapitale, kanë mundur të plotësojnë pjesërisht nevojat në rritje për shpenzimet e personelit dhe ato operative. Tkurrjen më të lartë të shpenzimeve kapitale e kanë qarku i Korçës në -48%, qarku i Lezhës në -47.4%, qarku i Shkodrës në -47.4% dhe qarku i Fierit në -40%.

Në nivel të bashkive, tkurrja e shpenzimeve në total dhe sipas kategorive të shpenzimeve, është më e diferencuar. Janë 24 bashki të cilat kanë treguar ulje të shpenzimeve të personelit dhe 37 të tjera të cilat i kanë rritur shpenzimet e personelit. Janë 32 bashki të cilat kanë ulur shpenzimet korente dhe 29 të cilat i kanë rritur. Janë 43 bashki të cilat i kanë ulur shpenzimet kapitale dhe 18 bashki të cilat i kanë rritur ato. Bashkitë më të mëdha në popullsi si Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora kanë tkurrjen më të madhe në shpenzimet kapitale me rreth -32.2% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Një tregues tjetër është intensiteti mesatar i diferencuar i uljes së shpenzimeve sipas kategorive. Në bashkitë që kanë pasur tkurrje të shpenzimeve, intensiteti mesatar i uljes së shpenzimeve të personelit është -3.8%, i shpenzimeve korente është -13.6%, dhe i shpenzimeve kapitale është -43.4%.

Mungesa e fondeve të mjaftueshme për të plotësuar kryesisht nevojat ndaj masave të mbrotjes është reflektuar në riallokimin ndërmjet funksioneve. Në nivel agregat fondet janë transferuar nga funksionet ekonomike dhe sociale, në funksionet e rendit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Në krahasim me vitin 2019, në vitin 2020 shpenzimet sipas funksionit ekonomik² kanë rënie në -27.4%, sipas funksionit të strehimit në -19.1%, të kulturës në -6.7%, të arsimit në -5%. Ulja më e lartë dhe me efekte sociale është ulja e shpenzimeve sipas funksionit social në -32.8%.

Efektet ekonomike në nivel të njërive të vetëqeverisjes vendore u shfaqën me ndërprejen e aktiviteteve të një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve, kryesisht të vogla dhe të mesme, për shkak të bllokimit administrativ si dhe përkeqësimit të treguesve të tyre ekonomik dhe financiar. Goditjen më të madhe nga mbyllja e kanë pësuar ndërmarrjet e vogla, të cilat kanë punësuar nga 5 deri në 9 veta. Llogaritet në 986 numri i këtyre ndërmarrjeve të mbyllura në vitin 2020 krahasuar me fundin e vitit 2019. Një efekt tjetër por që nuk është

² Në funksionin ekonomik përfshihen shpenzimet ekonomike të përgjithshme, për, punësimin, bujqësinë, tregtinë pylltarinë, peshkimin dhe gjuetiën, hidrokarbure dhe energji, miniera dhe ndërtim, transport, komunikacion, industri të tjera, si dhe kërkime shkencore

e mundur të matet është mbyllja e përkoheshme e aktivitetit veçanërisht në tremujorin e parë dhe të dytë. Sipas llojit të aktivitetit ndërmarrjet e akomodimit dhe të tregtisë mbeten më të prekura gjatë pandemisë. Në fund të vitit 2020 ka 727 më pak ndërmarrje aktive të akomodimit dhe shërbimit, ka 656 ndërmarrje më pak në tregti dhe 937 ndërmarrje më pak në sektorin e prodhimit të shërbimeve.

Mbyllja e aktiviteteve shkaktoi uljen e punësimit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në situatën financiare të familjeve, por dhe në atë të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Shkalla e punësimit ka një ulje të menjëhershme në tremujorin e dytë të vitit 2020. Shkalla e punësimit është ulur nga 53.1% në tremujorin e parë të vitit 2020 në 51.7% në tremujorin e dytë të vitit 2020. Ulja ka qenë me intensitet më të lartë në grupmoshat 15-29 vjeç, nga 42.7% në tremujorin e parë në 39.7% në tremujorin e dytë.

Efektet sociale të pandemisë u shfaqën me rritjen e nivelit të papunësisë si dhe të rritjes së familjeve në ndihmë ekonomike. Numri i të papunëve të regjistruar për herë të parë u rrit nga 5,617 persona në tremujorin e parë të vitit 2020 në 14,867 persona në tremujorin e dytë të vitit 2020. Rritja e numrit të të papunëve ishte shumë e lartë për të papunët romë dhe egjiptianë, të atyre përfitues të pagesës së papunësisë dhe të kategorisë përfitues të ndihmës ekonomike. Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike u rrit nga 59 540 familje në fund të vitit 2019, në 60 464 në tremujorin e parë të vitit 2020. Ndërsa në tremujorin e dytë u rrit në 63 670 familje ose mbi 5.3% më shumë krahasuar me tremujorin e parë. Masa e ndihmës mesatare të përfitimit në muaj për familje u ul ndjeshëm në – 12%. Nga 5,463 lekë në muaj për familje, ndihma mesatare e përfitimit u ul në 4,965 lekë.

Situata e krijuar nga pandemia u shoqërua me rritjen e çmimeve të mallrave si ushqimorë dhe atyre të shërbimit mjeksor. Rritja e çmimeve dhe në mënyrë të veçantë e kategorisë së mallrave ushqimorë u nxit nga efekti i masave të marra kundër pandemisë. Rritja më e lartë u reflektua në muajin mars të vitit 2020. Shpenzimet mesatare mujore të shëndetit për familje u rritën në vitin 2020 në 28% krahasuar me vitin 2019. Si pasojë grupet më në nevojë u gjendën në një situatë të rënduar sociale për të përballuar rritjen e kostos së produkteve dhe shërbimeve mjeksore. Kjo ka rezultuar në rritjen e kërkesës për ndihmë të ketyre grupeve ndaj NJVV-ve.

Rritja e papunësisë, ulja e të ardhurave, dhe rritja e kostove të produkteve ka rritur hendekun midis grupeve më të cënueshme dhe përqendrimit social të tyre. Një numër i konsiderueshëm i familjeve mbetën pa mbrojtje duke thëlluar më tej nivelin e varfërisë. Sipas raportit të Bankës Botërore³, Shqipëria në vitin 2020 jo vetëm ka rritjen më të lartë të nivelit të varfërisë, por dhe ka nivelin më të lartë të saj. Përqindja e popullsisë në nivelin e varfërisë u rrit në 5.9% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 41.5% të numrit të personave të cilët jetojnë me më pak se 5.5 dollarë amerikanë në ditë (në PPP 2011)⁴.

³ "Covid-19 and Human Capital, Europe and Central Asia Economic Update", Fall 2020, World Bank

⁴ Varfëria përcaktohet si një person që jeton me më pak se 5.5 dollarë/ditë në paritetin e rishikuar të fuqisë blerëse 2011 (PPP).

2. Hyrje

COVID-19, një sëmundje e transmetueshme e frymëmarrjes, u konfirmua si rast i parë në Rajonin Evropian më 24 janar 2020. Më 30 janar 2020 Organizata Botërore e Shëndetit shpalli epideminë e koronavirusit një urgjencë të shëndetit publik me interes ndërkombëtar. Shqipëria raportoi rastin e saj të parë më 8 Mars 2020. Ende e tronditur nga tërmeti i Nëntorit 2019, vëndi u përball me krizën e re duke shkaktuar vështirësi të mëdha ekonomike dhe sociale. Politika e mbrojtjes ndaj COVID -19, në shumicën e rasteve u zhvillua në nivel kombëtar, sapo virusi goditi Kinën dhe OBSH paralajmëroi vendet për nxitjen e masave mbrojtëse. Më 24 Janar 2020, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lëshoi Urdhrin për gatishmërinë dhe mbrojtjen për parandalimin e pandemisë, drejtuar institucioneve shëndetësore.

Në nivel lokal, gatishmëria ndaj pandemisë ishte e ulët për shkak të mungesës së njohurive mbi këtë sëmundje infektive, por edhe sepse bashkitë kanë struktura të dobëta institucionale të mbrojtjes civile, dhe nuk kanë strategji të përpunuar të mbrojtjes ndaj rrezikut nga fatkeqësitë. Krahas shtrëngimit të masave të kontrollit të miratuara në nivel qendror, bashkitë u përballën me nevojën për të përshtatur proceset e tyre në ofrimin e shërbimeve lokale, dhe reagimin e menjëhershëm ndaj urgjencës shëndetësore, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

3. Masat e marra nga Qeveria Qëndrore

Qeveria miratoi dy paketa mbështetëse në vitin 2020, për personat dhe bizneset e prekura nga pandemia COVID-19 në një fond prej 45 miliardë lekësh (2.8 përqind të PBB-së), të përbërë nga mbështetje buxhetore, garanci sovraane dhe shtyrje të taksave. Qeveria reagoi nëpërmjet krijimit të lehtësirave të përkohshme fiskale, në formën e faljes dhe të shtyrjes në kohë të disa detyrimeve tatimore, si edhe nëpërmjet rritjes së shpenzimeve në trajtën e transfertave të drejtpërdrejta për individët që humbën punën, apo për shtresat më vulnerabël të shoqërisë. Paketa e parë e miratuar më 19 Mars 2020, përmes një akti normativ, nënkuptonte masa mbështetëse prej 23 miliardë lekësh ose 1.4 përqind të PBB -së përmes një kombinimi të rialokimit të buxhetit të miratur, të rritjes së shpenzimeve dhe garancive sovraane për të mbështetur bizneset e prekura.

Masat kryesore përfshinin: (i) financim shtesë për sektorin e shëndetësisë në vlerë prej 2.5 miliardë lekësh (ii) 6.5 miliardë lekë për mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të vetëpunësuarve që u detyruan të mbyllin aktivitetin për shkak të pandemisë COVID-19 duke nënkuptuar pagimin e pagave në nivel minimal (deri në dy në rastin e bizneseve familjare me anëtarë të papaguar të familjes), dyfishim i përfitimeve të papunësisë dhe skemave të ndihmës sociale. (iii) në 2 miliardë lekë të shpenzimeve të mbrojtjes të rishpërndara në ndihmë humanitare për më të rrezikuarit, të cilat nuk u përdorën, (iv) 11 miliardë lekë (0.6 përqind e PBB -së) si fond i garancisë sovraane për kompanitë që të kenë akses në marrjen e kredisë në sistemin bankar për të paguar pagat për punonjësit e tyre, deri në 3 muaj, me një normë interesi të kufizuar në 2.85 përqind për një maturim deri në 2 vjet, ndërsa qeveria do të përballojë kostot e interesit.

Paketa e dytë, e miratuar në 15 Prill 2020, përfshin (i) 7 miliardë lekë (0.4 përqind të PBB-së) fond për të paguar për një transfer të njëhershëm prej 40,000 Lek për punonjësit e bizneseve

të vogla të prekura nga pandemia, që nuk mbulohen në paketën e parë, punonjës të bizneseve të mëdha të pushuar nga puna për shkak të pandemisë, dhe punonjës në sektorin e turizmit; (ii) një garanci sovraane prej 15 miliardë lekësh (0.9 përqind të PBB-së) për të siguruar kredi për kapital qarkullues me normë interesi të kufizuar në 5 përqind për të gjitha kompanitë private që ishin në përputhje me detyrimet fiskale, taksat me bilanc pozitiv para pandemisë. Qeveria do të garantojë 60 përqind të huave. Një paketë e tretë më e vogël mbështetëse u miratua më 13 Gusht, duke siguruar një pagë minimale shtesë për punonjësit e transportit publik që rifilluan punën një muaj më vonë se pjesa tjetër.

Qeveria gjithashtu miratoi masa të shtyrjes së taksave që lejojnë të gjitha kompanitë e mëdha (përveç bankave, telekomunikacionit, ndërmarrjeve publike dhe bizneseve të tjera thelbësore) të shtyjnë pagesën e tatimit mbi fitimin për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020 në vitin 2021. Sektori i turizmit, sektori i përpunimit aktiv (fason) si dhe qendrat e thirrjeve (call center) mund të shtynin pagesat për pjesën tjetër të vitit 2020 deri në vitin 2021. Bizneset e vogla me qarkullim nën 14 milionë lekë nuk do të paguajnë tatim mbi fitimin për pjesën e mbetur të vitit 2021.

Në shtator, qeveria nisi një program të promovimit të punësimit, që synonte mbulimin e një pjese të kostove të papunësisë të atyre që humbën punët e tyre gjatë bllokimit të aktivitetit për shkak të pandemisë. Për punonjësit e sektorit të formalizuar, qeveria do të mbulonte gjysmën e pagave në nivelin e tyre minimal ligjor dhe pjesën e plotë të punëdhënësve në kontributet sociale për kohëzgjatjen e programit. Punonjësit e sektorit jo formal që humbën punën gjatë pandemisë do të mbulojnë koston e plotë të kontributeve sociale, pjesa e kontributit të punonjësve dhe punëdhënësve për një vit nëse formalizohen.

4. Efektet ekonomike dhe sociale të pandemisë në treguesit kryesor makroekonomik

Pandemia globale COVID-19 ndërpreu aktivitetin ekonomik në të gjithë vendet përfshi dhe ekonominë shqiptare, duke i zhytur vendet në recession. Masat e marra për frenimin e saj dhe rritja e pasigurisë shkaktuan rënie të kërkesës për konsum dhe investime. Paralelisht me to, mbyllja e përkohshme e disa aktiviteteve të prodhimit e shërbimit solli një rënie të mëtejshme të prodhimit. Rënia e prodhimit u shoqërua me rënie të punësimit, rritje të papunësisë, rënie të të ardhurave familjare dhe vështirësi financiare për bizneset. Gjithashtu pasiguria për kohëzgjatjen e pandemisë solli një efekt shtesë në hezitimin për konsum, për rritjen e investimeve. Rënia e kërkesës së huaj ndikoi negativisht në eksportet shqiptare dhe në veçanti në goditjen ndaj turizmit.


Treguesit e ekonomisë kryesore në nivel agregat u përkeqësuan. Sipas Institutit të Statistikave, aktiviteti ekonomik në vend u tkurr me 3.85%. Ndërsa punësimi në tremujorin e katërt të vitit 2020, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2019, ra me 0.8% dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.8%. Shkaqet kryesore ishin rënia e kërkesës së brendshme dhe të jashtme, vartësia e ekonomisë shqiptare nga vendet partnere të rajonit, si dhe ndërprerjet në zinxhirët e furnizimit. Rënia ekonomike pasqyroi kontraktimin e njëkohshëm të thujesë të gjithë sektorëve të ekonomisë. Kontraktimi i ekonomisë u shfaq veçanërisht në fillim të vitit, kur aktiviteti në një numër sektorësh të rëndësishëm u mbyll për shkak të masave administrative.

Në tremujorin e dytë ekonomia pësoi një tkurrje të rëndë prej -10.6 përqind. Kriza goditi në mënyrë të veçantë flukset tregtare dhe sektorin e shërbimeve, si aktivitetet më të ekspozuara ndaj kufizimeve të vendosura. Duke pasur parasysh strukturën e ekonomisë, efekti negativ ishte më i lartë në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pas mbylljeve të aktivitetit ekonomik, në tremujorin e dytë dhe të tretë ekonomia tregoi shenja të rimëkëmbjes pasi kufizimet u lehtësuan dhe turizmi dhe aktivitetet e tjera ekonomike u rritën. Recesioni ishte i rëndë veçanërisht në vendet që mbështeten në turizëm si dhe në përpunimin aktiv.

Tkurrja e aktivitetit ekonomik ishte veçanërisht e fortë në degët e tregtisë në një rënie reale të aktivitetit në -11.56%, të transportit dhe informacionit në -2.65%, dhe të akomodimit dhe argëtimit në -6.89%, ku përfshihen aktivitetet më të prekura nga kufizimet e vendosura, në -11.56%. Edhe industria përpunuese dhe ajo nxjerrëse kontribuan në rënien ekonomike me një rënie të rritjes reale në -5.39%. ndonëse në një masë relativisht më të ulët në 0.5 pikë përqindje secila.

Ndërkohë, patën rritjet e vlerës së shtuar degët e bujqësisë, pyje dhe peshkim, ndërtim, pasuritë e paluajtshme dhe administrata. Një rënie të madhe pati sektori i turizmit veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2020. Turizmi nuk shprehet si aktivitet më vete. Turizmi është i përfshirë në disa aktivitete, të tilla si tregtia, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor, transport, arte, argëtim, çlodhje, etj.

Grafiku 1: Rritja reale e PBB në nivel agregat dhe sipas degëve



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit


Sipas Anketës së Forcave të Punës, punësimi u tkurr me 0.8% dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.8% në tremujorin e katërt të vitit. Rënia e punësimit ishte më e fortë në tremujorin e dytë, kur numri i të punësuarve u pakësua me 33,235 individë, duke e çuar në 50,035 numrin e vendeve të punës të humbura gjatë gjysmës së parë të vitit. Aktivitetet ekonomike më të prekura nga rënia e punësimit ishin hotelet, bar-restorantet, agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë, si edhe industria përpunuese e ajo nxjerrëse.

Pavarësisht problemeve strukturore, treguesit e tregut të punës u korrigan relativisht pas bllokimit fillestar dhe ekonomia filloi të hapet. Në verë, me lehtësimin e masave kufizuese, punësimi u rikthye me turizmin dhe rindërtimin që thithi pjesërisht humbjet në punët e prodhimit. Megjithatë, numri i të punësuarve në ekonomi mbeti më i ulët se një vit më parë.

Vendet e punës në tremujorin e katërt të vitit 2020 mbetën rreth 10 000 më pak se në tremujorin e fundit të vitit 2019.

Tkurrja e punësimit u shoqërua me rritje të shkallës së papunësisë, nga 11.2% në tremujorin e katërt të vitit 2019, në 11.4% dhe 11.9% në dy tremujorët e parë të vitit 2020. Në tremujorin e tretë, shkalla e papunësisë zbriti në 11.6%, ndërsa në tremujorin e katërt të vitit u rrit në 11.8% duke mbetur më e lartë se niveli i regjistruar përpara pandemisë. Humbjet e vendeve të punës prekën në mënyrë disproporcionale kategorinë e të rinjve. Shkalla e papunësisë e të rinjve në moshën 15-29 vjeç u rrit nga 20.0% në tremujorin e parë të vitit 2020 në 21.7% në tremujorin e IV të vitit 2020.

Grafiku 2: Niveli i papunësisë dhe indeksi çmimeve në përqindje



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Indeksi i çmimeve të konsumit mesatar vjetor rezultoi 1.6% gjatë vitit 2020 duke qëndruar nën kufirin e synuar. Ecuria e inflacionit ishte e luhatshme e ndikuar më së shumti nga çmimet e ushqimeve. Kategoritë ushqimore kontribuan me rreth 90% në formimin e inflacionin total. Indeksi i çmimeve të konsumit arriti në 3.6%. Pandemia COVID -19 ndikoi dhe në rritjen e varfërisë. Rritja e çmimeve, humbja e vendeve të punës thelloi më tej shkallën e varfërisë në vend.

Sipas raportit të Bankës Botërore⁵, Shqipëria jo vetëm ka rritjen më të lartë të nivelit të varfërisë në vitin 2020, por dhe ka nivelin më të lartë të saj. Përqindja e popullsisë në nivelin e varfërisë u rrit në 5.9% krahasuar me vitin 2019, duke arritur në 41.5% në numrin e personave të cilët jetojnë me më pak se 5.5 dollarë amerikanë në ditë (në PPP 2011)⁶.


Rritja e eksporteve dhe e importeve mbeti negative dhe deficitin tregtar u thellua në vitin 2020. Deficiti i llogarisë korrente u rrit në -15.4% në vitin 2020 nga -13.8% në vitin 2019. Eksportet u ulën nga 6.6% e PBB në vitin 2019 në 6.0% e PBB në vitin 2020. Importet u tkurrën më shumë se eksportet në përgjigje të një zbehjeje të kërkesës private, nga 29.7% e PBB në vitin 2019, në 27.1% të PBB në vitin 2020. Remitancat vazhduan të rrjedhin në vend pavarësisht nga kriza

⁵ "Covid-19 and Human Capital, Europe and Central Asia Economic Update", Fall 2020, World Bank

⁶ Varfëria përcaktohet si një person që jeton me më pak se 5.5 dollarë/ditë në paritetin e rishikuar të fuqisë blerëse 2011 (PPP).

në vendet e BE -së ku jetojnë emigrantët. Rimëkëmbja e përshpejtuar e dërgesave të emigrantëve me një rritje në 12.6% në tremujorin e katërt, mbështeti stabilitetin e deficitit të llogarisë korrente. Pjesa e IHD -ve në PBB -në u ul në 6.9% e PBB në 2020 në krahasim me 7.6% në vitin 2019.

Grafiku 3: Eksportet, importet, bilanci i pagesave, investimet e huaja dhe remitancat në përqindje të PBB




Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Rënia ekonomike tkurri të ardhurat fiskale, të cilat, të kombinuara me rritjen e shpenzimeve, sollën rritjen e shpejtë të deficitit fiskal dhe të borxhit publik. Shpenzimet publike u rritën në 33.4 përqind të PBB -së. Shpenzimet u rritën 9% në krahasim me vitin 2019, të nxitura nga rritja e shpenzimeve kapitale prej 13.5% kryesisht për rindërtimin nga tërmeti i vitit 2019. Të ardhurat ranë në 26.5% e PBB ose në terma nominale në -7.5% në krahasim me vitin 2019. Ecuria e të ardhurave u përcaktua nga një seri faktorësh, si tkurrja ekonomike, lehtësirat fiskale të implementuara, dhe rënia e çmimit të karburantit në tregjet ndërkombëtare.

Të ardhurat tatimore në vlerë nominale ranë 6.5% në krahasim me vitin 2019. Por tkurrja e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin dhe të ardhurat për të cilat u dha një lehtësim tatimor, por edhe të ardhurat nga taksat ranë të gjitha me më shumë se 20%. Ndërsa kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të ardhurat nga TVSH-ja regjistruan hyrje pak më të ulëta, në -0.7% dhe -1.6% respektivisht. Deficiti fiskal i konsoliduar arriti në 6.9% të PBB-së, dhe në terma nominale rreth 3.5 herë më shumë se në vitin 2019. Bilanci primar nga një nivel pozitiv në periudhën 2016-2019, u kthye në një nivel negativ në 4.7% e PBB.

Rritja e deficitit ishte rezultat i rënies së të ardhurave tatimore, si edhe nga rritja e shpenzimeve të destinuara për zbutjen e goditjes negative në ekonomi, apo atyre për rindërtimin e infrastrukturës dhe të banesave të dëmtuara nga tërmeti. Raporti i borxhit publik ndaj PBB arriti në 77.9% të PBB-së në fund të vitit 2020, nga 66.3% në fund të vitit 2019. Kjo erdhi si pasojë e rritjes së deficitit buxhetor, emetimit të garancive shtetërore, si edhe efektit të tkurrjes së PBB-së.

Grafiku 4: Të ardhurat, shpenzimet, deficit buxhetor, bilanci primar dhe borxhi në përqindje të PBB



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Konkluzione

Përkeqësimi i situatës për shkak të bllokimit të aktiviteti ekonomik u reflektua në përkeqësimin e treguesve makroekonomikë. Efekti mbi ekonominë u reflektua në tkurrjen e rritjes ekonomike dhe kalimi në recesion, mbylljen e aktiviteteve dhe vendeve të punës, rritjen e çmimeve ushqimore dhe të produkteve jo ushqimore dhe në veçanti të medikamenteve dhe shërbimeve mjeksore për mbrojtjen dhe trajtimin ndaj pandemisë.

Efektet sociale u ndjenë në rritjen e shpejtë të papunësisë dhe veçanërisht në moshat 15-29 vjeç, mbylljen e vendeve të punës, thellimin e shkallës së varfërisë dhe marginalizimin e mëtejshëm social. Tkurraja e të ardhurave dhe nevoja për rritjen e shpenzimeve të nevojshme për të luftuar pasojat e pandemisë rezultuan në rritjen e lartë të deficitit fiskal dhe të borxhit publik.

5. Rishikimi i buxhetit të vitit 2020

Situata e krijuar kërkoi rishikimin e treguesve ekonomikë dhe fiskalë, pritshmëria e të cilave ishte përkeqësimi i tyre. Pandemia COVID-19 krijoi një vështirësi si dhe sfidë për financat publike. Si në të gjitha vendet, dhe Shqipëria u përball me një rritje të deficitit buxhetor për shkak të rritjes së shpenzimeve publike, lidhur me masat për përballimin e krizës si dhe uljen e të ardhurave publike si rezultat i kontraktimit të ekonomisë dhe masave lehtësuese fiskale.

Rishikimi i buxhetit të miratuar për vitin 2020 u reflektua në katër akte normative. Të ardhurat publike u rishikuan me një rënie nominale prej 21.6 përqind krahasuar me buxhetin e miratuar. Shpenzimet publike u rritën në 5.5 përqind nominalisht, për shkak të shpenzimeve aktuale dhe për shkak të masave stimuluese të miratuara për të lehtësuar ndikimin e recesionit të shkaktuar nga pandemia.


Tabela 1: Treguesit fiskalë në miliard lekë

	Buxheti i miratuar	AN Nr 6 datë 21.3.20	AN Nr 15 datë 15.4.20	AN Nr 28 datë 02.7.20	AN Nr 34 datë 16.12.20	Ndryshimi në % AN Nr 34 /Buxheti
Të ardhurat	569.68	489.68	489.68	446.57	446.57	-21.6
Shpenzimet	549.37	558.37	558.37	579.54	579.54	5.5
Personeli	83.20	83.20	82.15	81.88	81.13	-2.5
Operative	49.85	50.63	49.34	51.11	51.28	2.9
Interesat	40.95	41.45	41.45	40.30	39.16	-4.4
Subvencione	1.29	1.29	1.34	1.54	1.96	51.9
Fondet speciale	188.59	189.79	189.79	188.37	189.37	0.4
Buxheti vendor	57.55	57.55	57.55	53.49	53.28	-7.4
Tjera sociale	24.60	24.60	24.60	24.80	25.80	4.9
Kapitale	81.64	80.84	75.95	87.84	89.34	9.4
Rindërtimi	20.00	20.00	20.00	20.00	32.00	60.0
Rezervë	1.70	9.20	16.20	16.20	16.20	9.5 herë
Deficiti buxhetor	39.70	68.70	68.70	132.97	132.97	3.3 herë

Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

Gjithësesi rritja e shpenzimeve nuk ishte propocionale. Shpenzimet e personelit të rishikuara u ulën në 2.5% krahasuar me buxhetin e miratuar. Shpenzimet për interesa gjithashtu u rrishikuan në ulje në -4.4%. Shpenzimet operative u rritën në vlerë nominale në 2.9%, të shpenzimeve të fondeve speciale në 0.4%, dhe të shpenzimeve të tjera sociale në 4.9%. Rritje të lartë në rishikimin e buxhetit patën shpenzimet kapitale si dhe fondet për rindërtimin. Ndërsa njësitë e vetëqeverisjes vendore rishikuan buxhetin e tyre duke ulur në mënyrë të ndjeshme prishmërinë e realizimit të të ardhurave të tyre. Kjo pati një ndikim në një rishikim të buxhetit total vendor në ulje në -7.4%.

Grafiku 5: Rritja e shpenzimeve buxhetore në përqindje



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Shpenzimet kapitale, përfshi shpenzimet për rindërtimin, u rritën në krahasim me PBB –në nga 4.6% në buxhetin e miratuar në 7.7% në aktin normativ përfundimtar. Shqipëria tregoi prioritet në rritjen e shpenzimeve kapitale përfshi ato të rindërtimit megjithëse kapacitetet

për të realizuar buxhetin kapital mbetën të ulta. Ndërsa nevoja e shfaqur për transferime të drejtëpërdrejta ndaj buxhetit vendor dhe të tjera shpenzime pati një vemendje të moderuar.

Shpenzimet për fondet speciale u rritën nga 10.5% e PPB në 12.0% të PBB. Shpenzimet e tjera sociale treguan një rritje të ulët nga 1.4% e PBB në 1.6% e PBB. Ndërsa shpenzimet e buxhetit vendor për shkak të rishikimit në ulje të të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, pavarësisht uljes nominale, patën rritje nga 3.2% në 3.4% të PBB. Në fakt kjo rritje është rezultat i uljes së vlerësimit të PBB në vlerë nominale.

6. Efektet e pandemisë në nivel të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Në nivel të vetëqeverisjes vendore efektet e pandemisë janë shumë dimensionale. Por në këtë analizë ne kemi synuar të tregojmë efektet ekonomike, sociale dhe fiskale. Efektet ekonomike në nivel të vetëqeverisjes vendore u shfaqën me ndërprejen e aktiviteteve të ndërmarrjeve kryesisht të vogla dhe të mesme si dhe biznesi i vogel për shkak të bllokimit administrativ si dhe për shkak të përkeqësimit të treguesve të tyre ekonomik dhe financiar. Efektet sociale në nivel të njësive të vetëqeverisjes vendore janë më të ndjeshme sepse njësitë e qeverisjes janë në një marrëdhënie të drejtëpërdrejtë me qytetarët për sigurimin e shërbimeve ekonomike dhe sociale. Krizat në përgjithësi kanë një tendencë për të përkeqësuar më tej situatën ekonomike dhe sociale të grupeve me në nevojë si dhe për thelluar nivelin e varfërisë. Grupet e pafavorizuara tentojnë të bëhen më të pafavorizuara. Grupet sociale që janë në kufirin e varfërisë relative të kalojnë në nivelin e varfërisë absolute.

Grupet e pafavorizuara përfshijnë punonjës në sektorin informal që për shkak të mbylljes së aktiviteteve mbetën në mënyrë të menjëhershme pa punë, punonjësit me të ardhura minimale të mbetur pa punë, të papunët apo familjet me ndihmë ekonomike, pensionistë apo familjarë të vetëm, familje me shumë fëmijë, invalidë, etj. Këto grupime sociale nuk patën burime apo rezerva financiare të mjaftueshme për të përballuar kostot shtesë si ato ekonomike, të shërbimeve të mbrojtjes, të shërbimeve mjeksore për trajtim, të kostove sociale, si dhe rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore.

Efektet fiskale në nivel të vetëqeverisjes vendore u shfaqën në kahun e shpenzimeve dhe të ardhurave. Nga eksperiencia e shumë vendeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore patën një ndikim negativ në shpenzimet e tyre. Në njërin krah ato u ndeshën me kërkesën për të rritur shpenzimet për të përballuar nevojat në fushën e shërbimeve, të përfitimeve sociale, për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe të vetëpunësuarve, të shëndetit publik, etj. Ndërsa në krahun tjetër në atë të uljes së shpenzimeve të personelit si dhe të shpenzimeve kapitale. Ndërkohë u përballën dhe me një rënie të të ardhurave të veta tatimore, tarife dhe jo tatimore.

Sipas raportit të OECD, efekti si në krahun e të ardhurave dhe të shpenzimeve është më i dukshëm për njësitë lokale të mëdha sesa në njësitë lokale më të vogla⁷. Rënia e të ardhurave përfshiu përgjithësisht të ardhurat e mbledhura nga taksat mbi pasurinë dhe taksat e tarifave

⁷ Raporti i OECD-së Ndikimi i krizës COVID-19 në qeveritë rajonale dhe lokale.


lokale. Bashkitë rurale dhe malore, të konsideruara si të pafavorshme për sa i përket hendekut ekonomik, u goditën gjithashtu më shumë nga pandemia në krahasim me bashkitë e tjera.

7. Efektet ekonomike si pasojë e Covid 19

Emergenca shëndetësore e shkaktuar nga përhapja e Covid-19 dhe masat e autoriteteve publike për kontrollin e saj, në Shqipëri përbëjnë një sfidë për stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, për shëndetin e financave të bizneseve dhe familjeve, si dhe për qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike të vendit. Situata e krijuar nga pandemia u shfaq drejtëpërdrejtë në mbylljen e aktivitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të biznesit të vogël dhe kryesisht në aktivitetet të cilat lidhen me akomodimin dhe shërbimet, prodhimin e shërbimeve, të tregtisë, etj.

Pavarësisht se numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2020 është 166 386 ose rreth 4 044 më shumë se në vitin 2019, struktura sipas aktiviteteve ka ndryshime të ndjeshme. Numri i ndërmarrjeve aktive në sektorin e akomodimit dhe shërbimeve, të tregtisë dhe të prodhimit të shërbimeve, ka rënie në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Në fund të vitit 2020 ka 727 më pak ndërmarrje aktive të akomodimit dhe shërbimit, ka 656 ndërmarrje më pak në tregti dhe 937 ndërmarrje më pak në sektorin e prodhimit të shërbimeve.


Grafiku 6 : Numri i ndërmarrjeve sipas sektoreve



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Goditjen më të madhe e kanë pësuar ndërmarrjet e vogla të cilat kanë punësuar nga 5 deri në 9 veta. Llogaritet në 986 numri i këtyre ndërmarrjeve të mbyllura në fund të vitit 2020 krahasuar me fundin e vitin 2019. Një efekt tjetër, por që nuk është e mundur të vlerësohet, është efekti në dinamikën mujore apo tremujore të numrit të ndërmarrjeve aktive, të cilat kanë mbyllur aktivitetin për shkak të masave administrative të ndërmarra për të ndaluar përhapjen e epidemisë.

Grafiku 7 : Numri i ndërmarrjeve sipas numrit të të punësuarve




Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Mbyllja e aktiviteteve shkaktoi uljen e punësimit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në situatën sociale të këtyre familjeve. Ulja e punësimit ka shkakuar një efekt ekonomik negativ dhe në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Dalja i papunë ka shtuar presionin për ndihmë tek njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushqime, medikamente të mbrojtjes, ndihmë financiare, etj.

Ulja e punësimit ka qënë më e lartë në grupmoshat 15-29 vjeç. Shkalla e punësimit ka një ulje të menjëhershme në tremujorin e dytë të vitit 2020. Shkalla e punësimit është ulur nga 53.1% në tremujorin e parë të vitit 2020 në 51.7% në tremujorin e dytë të vitit 2020. Ulja ka qënë me intensitet më të lartë në grupmoshat 15-29 vjeç, nga 42.7% në tremujorin e parë në 39.7% në tremujorin e dytë.

Grafiku 8: Shkalla e punësimit në përqindje



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Numri i të punësuarve sipas sektorëve tregon një ulje shumë të lartë në sektorin privat krahasuar me sektorin shtetëror dhe bujqësor. Në sektorin shtetëror kanë humbur punën në tremujorin e dytë të vitit 2020 në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2019, në rreth 1,366


persona, në sektorin shtetëror, 29,710 në sektorin privat dhe 17,643 persona në sektorin bujqësor.

Aktiviteti i ndërtimit është i një rëndësie të lartë për ecurinë e ekonomisë në nivel kombëtar, por dhe për vetë nivelin e qeverisjes vendore. Një ulje e aktivitetit të ndërtimit ka si pasojë një efekt fiskal të dyfishtë, në atë të rritjes së kërkesës për shërbime sociale për shkak të rritjes së papunësisë dhe në atë të uljes të të ardhurave tatimore të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ndërpreja e aktivitetit është e lidhur drejtëpërdrejtë me uljen e punësimit të punonjësve të formalizuar me shkallë kualifikimi të ulët si dhe në menyrë të menjëhershme të punonjësve informalë. Në krahun e shpenzimeve është rritur nevoja për të financuar kostot shtesë nga rritja e grupit të personave në nevojë.

Në krahun e të ardhurave është e lidhur me mbledhjen e të ardhurave të menjëhershme për dhënie të lejeve të ndërtimit. Në tremujorin e dytë të vitit 2020 ka një ulje shumë të ndjeshme të numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara. Numri i lejeve të ndërtimit në vitin 2020 është mbi 12% më i ulët se në vitin 2019. Ndërsa vlera e investimeve të ndërtimit sipas lejeve të miratua ka ulje në 5.2%.


Grafiku 9: Lejet e ndërtimit sipas numrit dhe vlerës në miliard lekë



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Rënia e lejeve të ndërtimit në vitin 2020 ka një korelacion me uljen e të ardhurave të mbledhura nga taksat e ndikimit në infrastrukturë. Ndërsa vlera e investimeve sipas lejeve të ndërtimit është ulur në -5.2% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, të ardhurat e mbledhura nga taksat e ndikimit në infrastrukturë kanë një rënie në 5.9% në vitin 2020.

Grafiku 10 : Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe vlera e ndërtimit në miliard lekë




Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Aktiviteti i tregtisë është një nga sektorët më të prekur gjatë pandemisë për shkak të mbylljes administrative. Rënia e indeksit të tregtisë me pakicë është e lidhur drejtëpërdrejtë me rënien e konsumit për shkak të tkurrjes së të ardhurave familiare. Ulja e aktivitetit të tregtisë për shkak të ndërprerjes goditi kryesisht biznesin e vogël dhe të mesëm duke u shoqëruar me efekte negative si për familjet e tyre por dhe me ulje të punësimit. Efekti negativ në nivel të njësisve të vetëqeverisjes vendore u reflektua si në rritjen e kostove të shërbimeve sociale por dhe uljen e të ardhurave tatimore dhe tarifore të tyre.

Rënia e indeksit të tregtisë me pakicë dhe në veçanti e mallrave jo ushqimore është më e lartë në tremujorin e dytë të 2020. Indeksi i tregtisë me pakicë ka një rënie në -4.3%, ndërsa indeksi i tregtisë së mallrave jo ushqimore në -7.1%.

Grafiku 11: Indeksi i tregtisë, me pakicë, i mallrave ushqimore dhe jo ushqimore në përqindje



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Sektori i shërbimeve dhe në veçanti i akomodimit hotelier është një nga sektorët më të prekur nga pandemia. Kjo për shkak të ndërprerjes së udhëtimeve ndërkombëtare dhe mbylljes së

aktivitetit të shërbimeve në vijim të masave të marra nga qeveria qendrore. Efekti i rënies së turizmit përveç efektit negativ në rritjen ekonomike, të bilancit të pagesave, të punësimit, pati dhe një ndikim shtesë negativ në të ardhurat nga taksa e hotelit për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Numri i netë qëndrimeve në total në vitin 2020 ra në mbi 50% në krahasim me vitin 2019. Rënia e ditë qëndrimeve është më lartë në mbi 62% për rezidentët e huaj dhe mbi 27% për rezidentët vendas. Numri total i ditë qëndrimeve ra nga 3,253,419 ditë qëndrimi në vitin 2019 në 1,605,444 ditë qëndrimi në vitin 2020. Rënia e numrit të ditë qëndrimeve mbetet më i lartë në tremujorin e dytë dhe të tretë në vitin 2020, krahasuar me të njëjtën tremujor në vitin 2019.


Tabela 2: Numri i netë qëndrimi në total, i rezidentëve dhe jo rezidentëve

	I-19	II-19	III-19	IV-19	I-20	II-20	III-20	IV_20
Numri i nete qendrimeve	195677	610736	1986333	460673	177356	142611	1094015	191462
Rezident	96953	191920	533057	281975	106164	109633	484185	100046
Jo rezident	98724	418816	1453276	178698	71192	32978	609830	91416

Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Korelacioni ndërmjet numrit të ditë qëndrimeve dhe të ardhurave të mbledhura nga taksa e hotelit për vitin 2019 dhe 2020 është i rëndësishëm. Rënia e ditë qëndrimeve është shoqëruar në rënie të mbi 62 % të të ardhurave nga taksa e hotelit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Grafiku 12: Numri i netë qëndrimeve dhe të ardhurat nga taksat e fjetjes në milion lekë



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

8. Efektet sociale si pasojë e Covid 19

Efektet e pandemisë u shfaqën me humbjen e vendeve të punës, të rritjes së papunësisë, të rritjes së familjeve në ndihmë ekonomike dhe në thellimin e varfërisë. Thellimi i varfërisë është rezultat i uljes së të ardhurave të familjeve dhe rritjes së kostove të produkteve dhe të

shërbimeve. Një anketim i kryer nga Co-Plan dhe Shoqata Për Autonominë Vendore (2020) ka treguar se 80% e bashkive deklaruan se prisnin të përballen me një rritje të shkallës së papunësisë, numrit të familjeve që mbështeten në ndihmën ekonomike dhe nivelit të varfërisë⁸.

Gjithashtu efektet e pandemisë u shoqëruan me rritjen e çmimeve të mallrave si ushqimorë dhe atyre të shërbimit dhe medikamenteve mjeksore. Si pasojë grupet sociale më në nevojë u gjendën në një situatë më të rënduar ekonomike për të përballuar si rritjen e kostos së produkteve, por dhe nevojën për një trajtim mjeksor. Pandemia ka rritur hendekun midis grupeve më të cenueshme, duke thelluar më tej varfërinë dhe pabarazinë sociale.

Një numër i konsiderueshëm i familjeve mbetën pa mbrojtje ekonomike për shkak të strukturës së sistemeve të mbrojtjes sociale. Njerëzit që vuajnë nga një gjendje kronike shëndetësore, njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë dhe viktimat e dhunës në familje, pakicat, njerëzit e prekur nga tërmeti, janë ata që përballen me rrezikun më të madh nga pasojat e COVID-19.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore u vunë përballë një situatë të jashtëzakonshme për mbështetjen ekonomike, shëndetësore dhe sociale të grupeve në nevojë. Kriza ka zbuluar pamundësinë e sistemeve të mbrojtjes sociale, dhe në mënyrë të veçantë për vendin tonë, që kanë kapacitet të limituar të burimeve financiare për të ofruar ndihmë adekuate si në nivel qendror dhe lokal.


Njësitë e vetëqeverisjes vendore u gjendën në një situatë të vështirësive për mbulimin e nevojave për ushqime, për trajtimin mjeksor dhe medicamente. Paga minimale e ofruar për shkak të mbylljes së aktiviteteve si dhe papunësisë u vu në dispozicion kryesisht për të punësuarit të formalizuar, gjë që praktikisht përjashtoi mbështetjen për fermerët, për personat në nevojë në zonat rurale dhe shumë punëtorë në sektorë informalë.

9. Rritja e çmimeve si pasojë e Covid 19

COVID-19 shkaktoi mbyllje të përkohshme të prodhimit të ushqimeve dhe produkteve bujqësore, duke shkaktuar një rritje të çmimeve. Rritja e çmimeve dhe në mënyrë të veçantë e kategorisë së mallrave ushqimorë, u nxit nga efekti i masave të marra kundër pandemisë.

Rritja më e lartë e çmimeve u reflektua në muajin mars, periudhë në të cilën u shënuar një normë e lartë e rritjes. Indeksi i çmimeve të mallrave ushqimorë dhe pije jo alkoolike arriti nivelin më të lartë prej 104.6 krahasuar me muajin shkurt 2020.

⁸ The response of local governments during Covid – 19 emergencies in Albania, January 2020 – April 2020, Co-Plan dhe Shoqata për Autonominë Vendore

Grafiku 13: Indeksi i çmimeve i disa kategorive në përqindje

Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Sipas kategorive të shportës, çmimet e “ushqimeve të papërpunuara” kanë qenë kontribuesit kryesorë në inflacionin e tremujorit të parë të vitit. Inflacioni mesatar i tremujorit të dytë rezultoi 1.9%, duke qëndruar 0.3 pikë përqindje më lart se vlera e shënuar në tremujorin paraardhës. Kategoria e produkteve ushqimore kontribuoi me rreth 90% në formimin e inflacionit total dhe veçanërisht kategoria e “ushqimeve të papërpunuara”.

Tabela 3: Ndryshimi i indeksit të çmimeve sipas kategorive në përqindje

	I-19	II-19	III-19	IV-19	I-20	II-20	III-20	IV-20
Mallra ushqimore te perpunuara	0,1	0,2	0,3	0,3	0,4	0,5	0,5	0,5
Mallra ushqimore te paperpunuara	1,3	0,8	0,7	0,8	0,8	1,2	0,8	1,0
Sherbime	0,0	0,0	0,1	0,1	0,2	0,4	0,2	0,1
Strehimi	0,1	0,2	0,1	0,0	0,2	0,3	0,3	0,3
Mallra te konsumit jo ushqimor	0,1	0,2	0,1	0,0	0,0	-0,2	0,2	-0,4
Karburant	0,1	0,1	0,0	-0,1	0,0	-0,3	0,3	-0,4
Konsum afat gjate	0,0	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1	0,1
Inflacioni	1,6	1,4	1,4	1,3	1,6	1,9	1,4	1,6


Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

10. Rritja e shpenzimeve të shëndetit si pasojë e Covid 19

Uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor, në vitin 2020, e ka shënuar grupi “Argëtim dhe kulturë” me 26,4 %, krahasuar me vitin 2019, ndërsa rritja më e madhe është shënuar në grupin “Shëndet” me 28,0 %. Rritja e shpenzimeve mesatare mujore për familje për shëndetin është reflektim i rritjes së nevojës për të shpenzuar për të siguruar masa mbrojtëse ndaj infeksionit si dhe të trajtimit në kushte të shtëpisë të të infektuarve nga COVID-19. Mbulimi i shpenzimeve është bërë nga buxheti vetjak i familjeve.

Tabela 4: Shpenzimet mesatare mujore për familje në muaj në lekë

	Shpenzimet per familje 2019 ne leke ne muaj	Shpenzimet per familje 2020 ne leke ne muaj	Ndryshimi ne %
Ushqim dhe pije jo alkoolike	33952	34173	0,7
Pije dhe duhan	3077	3130	1,7
Veshje dhe kepuce	4289	3875	-9,7
Banese, uje dhe energji	8291	8357	0,8
Mobilim dhe mirembajtje	5523	5794	4,9
Shendet	3506	4487	28,0
Transport	4871	5150	5,7
Komunikim	3036	3128	3,0
Argetim	3143	2315	-26,3
Arsim	2532	2607	3,0
Restorante	3988	4669	17,1
Sherbime tjera	6027	5250	-12,9



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

11. Ndhma ekonomike


Efektet e mbylljes së ekonomisë në numrin e familjeve me ndihmë ekonomike u reflektuan kryesisht në tremujorin e dytë të vitit 2020. Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike u rrit nga 59 540 familje në fund të vitit 2019, në 60 464 në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe në 63670 në tremujorin e dytë.

Tabela 5: Numri familjeve në ndihmë ekonomike dhe përfitimi mesatar mujor në lekë

	I-19	II-19	III-19	IV-19	I-20	II-20	III-20	IV-20
Numri i familjeve ne ndihme ekonomike	61177	61421	59954	59540	60464	63670	61160	60280
Ndhma mesatare e perfitimit ne muaj ne leke	5426	5036	5284	5154	5643	4965	5013	5021

Ndërsa numri i familjeve në nevojë u rrit në mbi 5.3% në tremujorin e dytë krahasuar me tremujorin e parë, ndihma mesatare e përfitimit në muaj për familje u ul ndjeshëm në – 12%. Nga 5,463 lekë në muaj për familje, ndihma mesatare e përfitimit u ul në 4,965 lekë. Kjo ka sjellë përqendrimin social të familjeve dhe thellimin e varfërisë për këtë shtresë.

Grafiku 14 : Numri i familjeve në ndihmë ekonomike dhe ndihma mesatare në lekë




Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

Rënia e aktivitetit ekonomik u shoqërua me rritje të papunësisë. Numri i të papunëve të regjistruar për herë të parë u rrit nga 5,617 persona në tremujorin e parë të vitit 2020 në 14,867 persona në tremujorin e dytë të vitit 2020. Rritja e numrit të papunëve ishte shumë e lartë për të papunët romë dhe egjiptianë, të atyre përfitues të pagesës së papunësisë dhe të kategorisë përfitues të ndihmës ekonomike. Rritja e kategorisë të të papunëve do të ushtronte presion mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore për të rritur koston e shërbimeve si rezultat i rritjes së kërkesës së tyre për mbështetje ekonomike dhe sociale.

Tabela Nr.6: Numri i të papunëve, përfitues të pagesës së papunësisë dhe të ndihmës ekonomike

	I-19	II-19	III-19	IV-19	I-20	II-20	III-20	IV-20
Te papune te regjistruar per here te pare	7.874	9.887	8.548	9.689	5.617	14.867	6.420	6.503
Te papune 15-29 vjec	516	553	549	574	582	562	634	636
Te papune romë dhe egjiptian	5.990	6.011	6.013	6.430	6.611	7.668	7.963	8.038
Perfitues te pageses se papunesise	3.150	3.083	2.598	2.652	2.970	3.656	6.300	6.051
Te papune te regjistruar ne ndihme ekonomike	21.151	22.118	21.914	21.994	22.780	26.203	28.605	28.944

Grafiku Nr 15 : Numri i të papunëve dhe pagesa mujore e papunësisë në lekë



Burimi: INSTAT dhe analiza e autorit

12. Rishikimi i buxheteve vendore

Për shkak të përkeqësimit të situatës ekonomike dhe rishikimit të buxhetit të qeverisë qendrore, këshillat bashkiak rishikuan parashikimet e të ardhurave të veta, mobilizuan fondet e mbartuara dhe përcaktuan prioritetet e reja të përdorimit të burimeve financiare. Një nga faktorët kryesorë të rishikimit të buxheteve vendore ishte tkurrja e pritshme e shkallës së mbledhjes së të ardhurave.

Ndryshimet e propozuara u reflektuan në Aktin Normativ Nr 28 të datës 02.07.2020. Deri në mesin e muajit prill 2020 buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore nuk ndryshoi krahasuar me nivelin e miratuar në ligjin e buxhetit. Me Aktin Normativ Nr 28, datë 02.07.2020 buxheti i vetëqeverisjes vendore rishikohet në ulje nga 57.55 miliard lekë në 53.49 miliard lekë. Ndërsa në Aktin Normativ Nr 34, datë 16.12.2020, buxheti vendor ulet në 53.28 miliard lekë.

Rishikimi në ulje i buxhetit vendor kryesisht reflektohet në Aktin Normativ Nr 28, datë 02.07.2020. Të ardhurat tatimore rishikohen në ulje në -14.4%, të ardhurat jo tatimore në ulje në -3.4% dhe financimi i huaj në -47%. Ndërsa transfertat e kushtëzuar rishikohet në një rritje të lehtë në +0.4%, dhe taksat e ndara në +33.3%. Ulja e buxhetit vendor në fund të vitit fiskal 2020 krahasuar me buxhetin fillestar është -7.4%.

Tabela 7: Treguesit fiskalë të buxhetit vendor në miliard lekë

	Buxheti i miratuar dhe AN Nr 6 dhe AN Nr 15	AN Nr 28 datë 02.7.2020	AN Nr 34 datë 16.12.2020	Ndryshimi në % AN Nr 34 /Buxheti
Të ardhurat tatimore nga pushteti vendor	26.94	23.05	23.05	-14.4
Shpenzimet e buxhetit vendor	57.55	53.49	53.28	-7.4
Transfertat	26.04	26.04	26.11	+0.3
Pa pakushtëzuar	18.20	18.20	18.27	+0.4
Pa kushtëzuar sektoriale	7.84	7.84	7.84	0.0
Të ardhurat tatimore	26.94	23.05	23.05	-14.4
Taksat e ndara	0.67	0.60	0.80	+33.3
Të ardhurat jo tatimore	2.90	2.80	2.80	-3.4
Financimi i huaj	1.00	1.00	0.53	-47.0

Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

13. Efektet fiskale të njësisve të vetëqeverisjes vendore si pasojë e Covid 19

COVID-19 shkaktoi një efekt negativ në financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore si në nivel të shpenzimeve ashtu dhe te të ardhurat. Ndryshimet fiskale u lidhën kryesisht me përjashtimet nga taksat e ndryshme të disa kategorive si personat me aftësi të kufizuara, nga ulja e tarifave lokale si ajo e zënies së hapësirës publike për muajt e emergjencës, tarifat e shërbimeve publike si ndriçimi, pastrimi dhe gjelbërimi, uljen e taksës mbi ndërtesën dhe token bujqësore, shtyrja e pagesave për taksat dhe tarifat vendore.

Si rezultat i mbylljes së aktiviteteve dhe i masave lehtësuese fiskale, të ardhurat e mbledhura të njësive të vetëqeverisjes vendore u tkurrën. Rënia e konsiderueshme e të ardhurave nga taksat lokale u reflektua veçanërisht në uljen e të ardhurave të taksës ndikimit në infra-strukturë të lidhur me lejet e ndërtimit, tarifa e zënies së hapësirës publike, tarifat e pastrimit dhe të gjelbërimit.

Ndërsa nevoja për financimin e shpenzimeve u rrit për shkak të rritjes së kostove si punëdhënës të njësive të vetëqeverisjes vendore, të shërbimeve si rezultat i masave anti Covid-19, të kostove sociale, të kostove për të mbrojtur shëndetin publik dhe shëndetin e punonjësve. Rritja e kërkesës për shërbime si rezultat i pandemisë rezultoi në:

- Identifikimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të infektuara brenda territorit të bashkisë dhe raportimi tek strukturat përgjegjëse
- Identifikimin e emigrantëve të kthyer, veçanërisht ata nga vendet shumë të prekura, duke dezinfektuar vendbanimet e tyre dhe zonën përreth njerëzve/familjeve të prekura.
- Identifikimin e kategorisë më në nevojë të përcaktuar sipas Vendimit të KM nr. 236/2020, por dhe më tepër, si familjet në kushte ekstreme të varfërisë, individë që jetojnë në kushte të pafavorizuara, komunitete rome dhe egjiptiane, nëna dhe gra beqare me urdhër mbrojtjeje, jetimë dhe fëmijë në rrezik
- Adresimin e nevojave të menjëhershme për furnizime ushqimore dhe jo ushqimore si ndihmë për grupet e pafavorizuara dhe të cënueshme
- Marrjen e masave për dezinfektimin e rrugëve dhe hapësirave të hapura publike, sigurimi i zbatimit të orëve të bllokimit, sigurimi i informacionit dhe këshillimit për qytetarët për të siguruar që rregullat e distancës sociale, kontrolli dhe monitorimi i tregjeve për distancat mes njerëzve për të shmangur mbipopullimin dhe hapjen e infeksionit.

Në seksionin e mëposhtëm është treguar se nuk ka patur asnjë mbështetje financiare shtesë të ofruar nga qeveria qendrore për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të kapërcyer hendekun negativ midis nevojës për shpenzime në rritje dhe tkurrjes së të ardhurave. Transferta e pakushtëzuar nga 26.04 miliard lekë në buxhetin e vitit 2020 të planifikuar në buxhetin e miratuar u rrit në një shumë të papërfillshme me aktet normative gjatë vitit 2020 në 26.11 miliard lekë. Burimet e financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore mbetën të limituara si për shkak të kontraktimit të të ardhurave të veta, të mos përdorimit tërësor të transfertës të pakushtëzuar, të mos realizimit të financimit të huaj, etj.

Në këto kushte këshillat bashkiak miratuan vendime për të përdorur fondet e emergjencës dhe të ardhurat e tyre të mbartura. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rialokuan fondet nga shpenzimet kapitale në shpenzimet e personelit dhe shpenzimet operative për të përballuar nevojën e financimit të shpenzimeve ekonomike, sociale dhe shëndetësore për mbrojtjen ndaj pandemisë.

Ulja e shpenzimeve të personelit ka prekur jo vetëm volumin e shërbimeve të ofruara për qytetarët, por dhe ka prodhuar një efekt social shtesë. Ndërsa ulja e shpenzimeve kapitale ka ndikuar negativisht për ekonomitë lokale, duke prekur kryesisht sipërmarrjet e lidhura me kontratat e shërbimeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të turizmit.

Ndërprerja e kontratave me investitorët apo sipërmarrësit privatë për aktivitete apo produkte të lidhura me shpenzimet kapitale përkeqësoi treguesit ekonomikë financiarë dhe të punës të këtyre ndërmarrjeve. Megjithatë, si kontraktimi i të ardhurave fiskale në total dhe në zërat e saj si dhe i shpenzimeve mbetet i diferencuar në nivel të qarkut dhe të bashkive.

14. Tkurrja e të ardhurave të veta në raport me buxhetin e miratuar dhe vitin fiskal 2019

Përkeqësimi i situatës ekonomike pati efekte direkte në të ardhurat fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore ishin të planifikuara në 26.94 miliard lekë për vitin 2020. Niveli i realizimit të të ardhurave në vitin 2020 është 21.98 miliard lekë. Sipas raportit të Co – Plan me fillimin e pandemisë bashkitë kundrejt planifikimit gjatë katër muajve të parë të vitit parashikuan ulje të mbledhjes së të ardhurave për vitin 2020, nga tarifat e shërbimit publik si pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, nga tarifa e zënies së hapësirës publike, nga taksat e pronës për ndërtesat, tokën bujqësore dhe truallin, taksat e hotelit dhe taksat e tabelave.

Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore varen nga ecuria e taksave lokale, taksat mbi pronën si dhe të ardhurat jo tatimore. Të ardhurat nga biznesi i vogël zenë një përqindje shumë të ulët në totalin e të ardhurave të veta. Mbledhja e të ardhurave nga taksat është e ndikuar në një shkallë të konsiderueshme nga taksat e ndikimit në infrastrukturë dhe taksat mbi pronën. Ndërtimi është ndër sektorët që u ndikuan më pak nga kriza COVID-19. Por të ardhurat e mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhen me dhënien e lejeve të ndërtimit, pavarësisht se si do jetë ecuria e vetë aktivitetit të ndërtimit të objekteve.

Ngadalsimi i aktivitetit të njësive të vetëqeverisjes ka ndikuar dhe në ecurinë e lejeve të ndërtimit dhe si rrjedhojë dhe në të ardhurat nga taksat e ndikimit në infrastrukturë. Të ardhurat nga taksimi i pronës u prekën negativisht por në një masë shumë më të ulët. Ndërsa taksat e akomodimit në hotel, e tabelës, si dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimeve (tarifa për menaxhimin e mbeturinave, tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit) në rishikimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore patën një pritshmëri negative. Gjithashtu impakti negativ mbi të ardhurat do të varej nga madhësia e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në krahasim me planifikimin e buxhetit niveli mesatar i mbledhjes së të ardhurave fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore rezultoi 81.2% ose një tkurrje në -18.8%. Një përqindje të lartë të tkurrjes së të ardhurave të mbledhura treguan të ardhurat nga taksat lokale në -22.4%. Të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë patën një rënie në -4.3%. Ndërsa të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar nga biznesi i vogël pati një rritje në 4%. Gjithashtu një tkurrje të lartë patën dhe të ardhurat jo tatimore në -22.4%⁹.

⁹ Një tregues tjetër në analizë i efektit negativ të pandemisë në të ardhurat fiskale të njësive të vetëqeverisjes lokale është dhe krahasimi i ecurisë së të ardhurave 9–mujore në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Në 9 mujorin e vitit 2021 të ardhurat fiskale të bashkive janë rreth 21.1 miliard lekë ose rreth 4.4 miliard lekë me shumë se e njëjta periudhë e vitit 2020.


në miliard lekë

Tabela 8: Të ardhurat e veta të buxhetit vendor në miliard lekë

Emërtimi	Buxheti i miratuar	Realizimi i të ardhurave	Ndryshimi në %
Të ardhurat tatimore	26.94	21.98	-14.4
Taksat lokale	21.22	16.47	-22.4
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	5.35	5.12	-4.3
Taksa e Biznesit të vogël	0.37	0.38	+2.7
Të ardhurat jo tatimore	2.90	2.25	-22.4
Të ardhurat e veta	29.84	24.23	-18.8

Ndërsa në krahasim me të ardhurat tatimore të mbledhura në vitin 2019, të ardhurat tatimore në vitin 2020 janë rreth -4.9 % më të ulta se në vitin 2019, ose pothuajse në një nivel me vitin 2018.

Grafiku Nr 16: Të ardhurat tatimore vendore në miliard lekë



Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

15. Impakti në të ardhurat e veta sipas zërave

Analiza e të ardhurave të veta sipas zërave përfshin të ardhurat nga taksat dhe tarifat si dhe të ardhurat jotatimore. Analiza sipas zërave nuk mund të bëhet në raport me buxhetin e miratuar sepse mungojnë të dhënat e buxhetit të miratuar në bazë të zërave. Për të analizuar

Emërtimi	2020	2021	Ndryshimi
Të ardhurat nga taksat pasuri, paluajtshme	3.9	4.9	1.0
Të ardhurat nga taksat lokale	12.5	15.8	3.4
Të ardhurat nga taksa biznesi i vogël	0.4	0.4	-
Të ardhurat fiskale	16.7	21.1	4.4

Burimi : Ministria e Financave dhe analiza e autorit

efektin sipas zërave është marrë në analizë realizimi i të ardhurave sipas zërave në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

15.1 Të ardhurat e veta të pushtetit lokal

Për dy vitet që janë marrë në analizë, të ardhurat e veta kanë treguar një rënie në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Peshën më të lartë në të ardhurat e veta të njësisve të vetëqeverisjes vendore e kanë të ardhurat tatimore dhe tarifore. Dinamika e të ardhurave totale përcaktohet pothuajse nga ecuria e të ardhurave nga taksat dhe tarifrat. Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifrat kanë një rënie në -4.9%. Ndërsa një rënie më të lartë kanë treguar të ardhurat jo tatimore në -10.4%.

Në nivel agregat të qeverisjes vendore tkurrjen më të lartë e kanë pasur të ardhurat nga tatimi mbi pasurinë, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e lidhur me lejet e ndërtimit, taksa e fjetjes e lidhur me turizmin, taksat vendore të përkohëshme, tarifrat për zënien e hapësirës publike e lidhur me bllokimin e aktiviteteve të shërbimeve, si dhe të ardhurat nga tarifa e gjelbërimit.

Tabela 9: Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në miliard lekë

Emërtimi	2019	2020	Ndryshimi në %
Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat	23.10	21.98	-4.9%
Të ardhurat jo tatimore	2.51	2.25	-10.4%
Të ardhurat e veta	25.61	24.23	-5.5%

15.2 Të ardhurat tatimore nga taksat dhe tarifrat

Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat e njësisve të vetëqeverisjes vendore përcaktohen nga ecuria e të ardhurave të taksave lokale që kanë peshën më të madhe në të ardhurat tatimore. Kjo kategori e të ardhurave përmbledh të ardhurat nga taksat mbi pasurinë, të ardhurat nga taksat lokale dhe të ardhurat nga biznesi i vogël. Të ardhurat lokale zenë rreth 75% e të ardhurave tatimore dhe tarifore, të ardhurat nga pasuria zenë 23.3%, ndërsa të ardhurat nga biznesi i vogël zenë 1.7%. Një ndryshim i lartë është evidentuar në të ardhurat nga taksat lokale.

Taksat lokale kanë një rënie në -6.2%, ndërsa të ardhurat nga taksat mbi pasurinë kanë pasur një rënie më të lehtë në -1.7%. Ndërkohë të ardhurat nga biznesi i vogël kanë pësuar një rritje në 5.5% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Të ardhurat nga taksat nga pasuria në vitin 2020 kanë realizuar 5.1 miliard lekë, ndërsa në vitin 2019 kanë realizuar 5.2 miliard lekë ose 0.1 miliard lekë. Të ardhurat nga taksat lokale kanë realizuar 16.5 miliard lekë ose 1 miliard lekë më pak se në vitin 2019. Ndërsa të ardhurat nga biznesi i vogël kanë realizuar 383.5 milion lekë ose 28.5 milion lekë më shumë se në vitin 2019.

Tabela 10: Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat në miliard lekë

Emërtimi	2019	2020	Ndryshimi në %
Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme	5.21	5.12	-1.7%
Të ardhurat nga taksat dhe tarifrat lokale	17.54	16.45	-6.2%
Të ardhurat nga biznesi i vogël	0.36	0.38	+5.5%
Të ardhurat totale nga taksat dhe tarifrat	23.10	21.98	-4.9%

15.3 Të ardhurat lokale nga taksat dhe tarifat

Në të ardhurat lokale nga taksat dhe tarifat përfshihen taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksat e fjetjes, taksa e tabelës, taksa vendore të përkohëshme, taksa të tjera, si dhe tarifat vendore për zënien e hapësirës publike, të pastrimit dhe higjenës, dhe tarifat vendore të gjelbërimit. Ecuria e të ardhurave nga taksat lokale përcaktohet nga dinamika kryesisht e të ardhurave nga taksa e ndikimit mbi infrastrukturë që zënë mbi 48% të të ardhurave nga taksat lokale, të të ardhurave të tjera që zënë 22% dhe të ardhurat nga tarifa e pastrimit që zënë 22.7% të të ardhurave të taksave lokale. Ndërsa të ardhurat nga taksat e fjetjes në 0.6%, të ardhurat nga taksa e tabelës në 1.8%.

Të gjitha kategoritë e të ardhurave kanë pësuar ulje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, përveç taksës së pastrimit dhe të higjenës që ka treguar një rritje të lehtë në 0.3%. Taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë peshën më të madhe të taksave lokale, ka shënuar një ulje në -5.9%, taksa e tabelës në -3.1%, taksat vendore të përkohëshme në -7.7%, taksat e tjera në -6.2%, tarifat vendore për zënien e hapësirës publike në -20.8%, tarifat vendore e gjelbër -9.1%. Taksa që ka rënien më të lartë është taksa e fjetjes, e cila ka shënuar një rënie në 96%.

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në nivel agregat në vitin 2020 janë 7.94 miliard lekë ose 500 milion lekë më pak se në vitin 2019. Të ardhurat nga taksa e fjetjes kanë treguar ulje më të madhe nga 250 milion lekë në vitin 2019 janë ulur në 95 milion lekë në vitin 2020. Të ardhurat nga taksimi i tabelës kanë realizuar 306 milion lekë në vitin 2020 ose 18 milion lekë më pak se në vitin 2019. Të ardhurat nga taksat e përkohëshme dhe të tjera kanë realizuar 3.62 miliard lekë në vitin 2020 ose rreth 240 milion lekë më pak se në vitin 2019. Ulja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është një tregues i drejtëpërdrejtë i rënies së veprimtarisë së ndërtimit gjatë pandemisë. Taksa vendore për zënien e hapësirave publike është një tregues i uljes së veprimtarisë së shërbimit të bareve dhe restoranteve. Ndërsa rënia drastike e të ardhurave nga taksa e fjetjes është tregues i pothuajse mbylljes së veprimtarisë të shërbi-meve të hotelerisë.

Tabela 11: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat lokale në miliard lekë

Emërtimi	2019	2020	Ndryshimi në %
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	8.44	7.94	-5.9%
Taksa e fjetjes në hotel	0.25	0.01	-96.0%
Taksa e tabelës	0.32	0.31	-3.1%
Taksa vendore e përkohëshme	0.78	0.72	-7.7%
Taksa të tjera	3.08	2.89	-6.2%
Tarifa për zënien e hapësirës publike	0.72	0.57	-20.8%
Tarifa e pastrimit dhe e higjenës	3.72	3.73	+0.3%
Tarifa vendore e gjelbër	0.22	0.20	-9.1%
Totali i taksave dhe tarifave lokale	17.54	16.45	-6.2%

Në kategorinë e taksave mbi pasurinë përfshihen taksat mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin. Të ardhurat nga taksimi i pasurisë zënë peshën e dytë në të ardhurat nga taksat. Dinamika e të ardhurave të pasurisë përcaktohet nga ecuria e të ardhurave nga taksimi i ndërtesave. Në nivel agregat të ardhurat nga taksimi i ndërtesave zënë mbi 74% të të ardhurave të taksës mbi pasurinë, të ardhurat nga taksimi i tokës bujqësore zë rreth 11% të të ardhurave dhe taksimi i truallit zë 4%.

Të ardhurat nga taksimi i pasurisë nuk ndikohen drejtë për së drejti nga rritja ekonomike. Dhe në rastin e pandemisë nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë tkurrja ekonomike me të ardhurat nga taksimi i pasurisë dhe në mënyrë të veçantë me taksimin e tokës bujqësore apo të truallit. Të ardhurat nga taksimi i ndërtesave në nivel agregart në vitin 2020 janë 3.8 miliard lekë ose rreth 120 milion lekë më pak se në vitin 2019.

Nga treguesit e të ardhurave të vitit 2020 dhe vitit 2019 ka një rënie vetëm për taksat mbi ndërtesat në -3.1%. Ndërsa taksat mbi tokën bujqësore dhe truallin kanë treguar rritje, respektivisht 3.8% dhe 16.7% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Të ardhurat nga taksimi i tokës bujqësore janë 543.7 milion lekë ose 26.3 milion lekë më shumë se në vitin 2019. Të ardhurat nga taksa e truallit janë 19.1 milion lekë më shumë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.


Tabela 12: Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë në miliard lekë

Emërtimi	2019	2020	Ndryshimi në %
Të ardhurat nga taksat mbi ndërtesat	3.92	3.80	-3.1%
Të ardhurat nga taksat mbi tokën bujqësore	0.52	0.54	+3.8%
Të ardhurat nga taksa mbi truallin	0.18	0.21	+16.7%
Të ardhura nga taksa mbi transaksionet	0.59	0.57	-3.4%
Të ardhurat totale nga taksa mbi pasurinë	5.21	5.12	-4.9%

15.4 Efekti i uljes së të ardhurave të veta është i diferencuar ndërmjet qarqeve

Në përgjithësi qarqet që kanë ulje të të ardhurave tatimore dhe tarifore kanë dhe ulje të të ardhurave totale të veta. Megjithatë, tkurrja e të ardhurave të veta të njëjësive të vetëqeverisjes vendore është e diferencuar ndërmjet tyre. Tkurrja mesatare e të ardhurave të qarqeve është -7.3% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Qarqet si Dibra, Durrësi, Lezha, Korça kanë uljen më të lartë se mesatarja e ndryshimit të të ardhurave. Tkurrjen më të madhe e ka qarku i Lezhës, i Durrësit dhe i Korçës. Vetëm qarku i Kukësit dhe i Vlorës kanë rritje të të ardhurave në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.


Grafiku Nr 17: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave të veta, tatimore dhe jo tatimore sipas qarqeve



Burimi: Analiza e autorit

Ashtu si shikohet dhe nga grafiku, dinamika e të ardhurave të veta në qarqe është përcaktuar përgjithësisht nga ecuria e të ardhurave tatimore dhe tarifore. Tkurrjen më të lartë në të ardhurat tatimore dhe tarifore e kanë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat lokale.

Grafiku Nr 18 : Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave tatimore sipas kategorive dhe qarqeve



Burimi: Analiza e autorit

Tabela 13: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave të veta dhe tatimore sipas qarqeve

	Te ardhurat e veta ndryshimi 2020/2019 ne %			Te ardhurat nga taksat ndryshimi 2020/2019 ne %			Te ardhurat nga taksat mbi pasurinë e palujtshme ndryshimi 2020/2019 ne %		
	Totali	Tatimore	Jo tatimore	Pasuri e Palujtshme	Lokale	Bisnesi	Ndertese	Toke Bujqesore	Truall
Tirana	-3.0	-2.3	-11.1	4.9	-4.2	17.2	4.3	6.0	145.3
Berati	-4.9	2.6	-42.5	5.7	0.9	31.2	1.1	9.5	-13.0
Dibra	-9.3	-11.8	2.7	7.2	-13.4	-54.1	4.6	3.9	0.0
Durrësi	-20.6	-19.5	-27.7	-27.6	-21.3	-12.6	-17.5	47.2	-85.0
Elbasani	0.0	1.7	0.1	14.4	-5.2	-19.8	13.4	-13.7	87.7
Fieri	-6.2	-4.7	-23.6	-4.1	-5.3	5.3	-39.6	11.2	42.6
Gjirokastra	-2.9	-7.1	12.6	-9.8	9.5	-6.2	-12.3	-4.6	100.0
Lezha	-52.6	-56.2	-10.2	7.5	-65.4	20.1	18.8	6.0	-36.3
Korça	-9.8	-7.2	-28.7	-2.7	-8.7	6.3	0.2	3.7	11.7
Kukësi	21.1	22.9	33.0	13.7	25.9	-7.1	12.9	81.8	100.0
Shkodra	-8.2	-7.4	-16.9	-16.1	-5.1	44.6	-17.0	-12.6	-3.5
Vlora	8.4	9.0	3.8	-20.5	24.3	-12.3	-26.1	8.4	2.6

Burimi: Analiza e autorit

Të ardhurat nga taksimi i pasurisë që zënë peshën e dytë në të ardhurat nga taksat përcaktohet përgjithësisht nga ecuria e të ardhurave nga taksimi i ndërtesave. Tkurrjen më të lartë e kanë bashkia e Fierit në -36.6%, bashkia e Vlorës -26.1%, bashkia e Durrësit në -17.5%, bashkia e Shkodrës -17.0%, dhe bashkia e Gjirokastrës -12.3%. Edhe ecuria e të ardhurave nga taksat lokale në nivel të qarqeve përcaktohet nga dinamika kryesisht e të ardhurave nga taksat e ndikimit në infrastrukturë që zënë mbi 48% të të ardhurave nga taksat lokale. Tkurrjen më të madhe të të ardhurave nga taksat e ndikimit në infrastrukturë e kanë qarqet e Lezhës në -89.2%, qarqet e Beratit -55.1%, qarqet e Dibrës në -50.3%, qarqet e Kukësit në -47.6%, qarqet e Durrësit në -32.7%, dhe qarqet e Elbasanit në -21.3%.

Tabela 14: Ndryshimi në % 2020 - 2019 i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat lokale sipas qarqeve

	Te ardhurat nga taksat lokale ndryshimi 2020/2019 ne %				Te ardhurat nga tarifatat lokale ndryshimi 2020/2019 ne %		
	Ndikimi ne infrastrukture	Fjetjes ne hotel	Tabeles	Tjera	Zenia e hapsires publike	Pastrimit	Gjelberimit
Tirana	-1.3	-65.1	-9.7	-17.3	-84.2	10.0	14.7
Berati	-55.1	-80.3	6.7	8.1	-27.6	9.1	77.5
Dibra	-50.3	-41.2	1.4	-8.4	47.1	14.4	-25
Durresi	-32.7	-76	-9.4	-1.8	-36.4	-15.5	-51
Elbasani	-21.3	-69.2	12.3	7.1	-15.1	-1.4	-3.9
Fieri	-9.2	-71.4	6.4	23.5	20	-35.2	-37
Gjirokastra	-16.8	-36.4	-10.8	-4.7	9.1	-3.3	11.1
Lezha	-89.2	-43.1	35.5	-33.1	-53.5	-12.8	-11.1
Korca	94.9	-45.4	13.5	-0.6	9.9	-10.7	-60.7
Kuksi	-47.6	-50	133.9	130	93.5	6.7	233.3
Shkodra	-13	-60.6	-3.5	2.2	-51.9	-15.8	-10.4
Vlora	99.8	-40.9	13.1	2.3	3	-11.4	-33.8

Burimi: Analiza e autorit

15.5 Efekti i uljes së të ardhurave të veta është shumë më i diferencuar ndërmjet bashkive

Ndryshimi i të ardhurave në përqindje, duke krahasuar vitin 2020 me vitin 2019, është i diferencuar (analiza në nivel të çdo bashkie sipas qarqeve është në Aneksin 1 bashkëngjitur). Numri i bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave të veta është më i lartë se i atyre të cilat kanë rritje të të ardhurave. Janë 31 bashki të cilat kanë ulje të të ardhurave të veta. Përqindja mesatare e uljes së të ardhurave është -19.7%. Të ardhurat tatimore e tarifore janë ulur në 33 bashki me një mesatare të uljes në -20%. Uljen më të madhe e kanë të ardhurat jo tatimore me një mesatare në -29.1% në 32 bashki.

Grafiku 19: Ndryshimi i të ardhurave të veta të bashkive në përqindje 2020 - 2019




Tabela 15: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave të veta dhe tatimore sipas bashkive

	Te ardhurat e veta	Te ardhurat tatimore	Te ardhurat jo tatimore		Te ardhurat e veta	Te ardhurat tatimore	Te ardhurat jo tatimore
Belsh	22,6	51,1	-77,6	Librazhd	3,2	0,8	14,7
Berat	4,0	13,1	-47,0	Lushnje	0,2	5,0	-43,6
Bulqize	-15,2	-20,1	-43,6	M. Madhe	3,2	8,8	-34,9
Cerik	8,9	11,3	-10,2	Maliq	0,3	-1,7	13,8
Delvine	18,0	6,5	42,2	Mallakaster	-28,3	-28,9	-24,9
Devoll	-7,7	31,7	-63,7	Mat	18,9	29,2	-20,4
Dibër	-17,8	-25,6	13,1	Memaliaj	21,7	2,6	75,0
Divjake	-10,0	-10,7	3,9	Mirdite	-16,6	-40,5	-19,0
Dropull	11,4	7,8	23,4	Patos	33,2	33,3	20,0
Durrës	-23,8	-24,8	-16,1	Peqin	-20,3	-22,1	44,4
Elbasan	-1,8	-2,9	10,3	Permet	-10,9	-13,5	5,9
Fier	-9,4	-7,6	-27,5	Pogradec	-0,3	0,0	-10,1
Finiq	2,8	4,6	-1,2	Polican	13,4	23,6	-21,7
F. Arez	-32,7	-13,6	-56,3	Prenjas	6,6	8,0	0,9
Gjirokaster	-7,5	-10,7	4,8	Puke	93,4	92,6	100,0
Gramsh	3,7	14,0	-33,8	Pustec	10,8	-38,2	6 here
Has	20,5	21,6	8 here	Rrogozhine	24,8	10,1	16,0
Himare	25,5	35,1	-43,1	Roskovec	-15,4	-19,1	66,7
Kamez	-37,4	-37,3	-41,4	Sarandë	5,4	2,7	100,0
Kavaje	-21,7	-22,9	-1,8	Selenice	-12,0	-10,3	-26,3
Kelcyre	7,0	-10,3	88,2	Shijak	-8,9	-0,8	-46,7
Klos	-27,2	-32,3	-4,2	Shkoder	-7,3	-6,5	-18,4
Kolonje	21,0	27,7	11,8	Skrapar	-37,4	-15,6	-56,6
Konispol	31,8	20,8	58,8	Tepelene	0,6	-3,1	6,0
Korce	-17,8	-17,2	-23,9	Tirane	0,0	1,1	-10,7
Kruje	-13,5	-0,8	-46,7	Tropoje	-19,8	-22,7	-7,6
Kucove	-22,5	-21,8	-29,0	U. Vajguror	7,1	5,6	37,7
Kukes	36,0	45,2	21,8	Vau i Dejes	-32,2	-36,2	52,9
Kurbini	-36,0	-40,5	-19,0	Vlore	4,8	5,1	2,7
Lezhe	-56,9	-59,9	0,3	Vore	-28,7	-28,8	-23,5
Libohove	-13,2	-15,9	0,0				

Analiza e strukturës së të ardhurave tatimore e tarifore dhe jo tatimore është gjithashtu relevante për të parë se në cilat raste bashkitë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia kanë mbledhur më pak të ardhura tatimore dhe tarifore ose kanë mbledhur më shumë të ardhura jo tatimore për të mundësuar një kompensim të plotë ose të pjesshëm të humbjeve të të ardhurave tatimore. Kompensimi i plotë i humbjeve nga të ardhurat tatimore dhe tarifore në fakt ka ndodhur në raste të pakta përderisa të ardhurat jo tatimore në nivel agregat zënë më pak se 10% të të ardhurave totale të veta.

Bashkitë janë klasifikuar në gjashtë kategori, (i) bashkitë të cilat kanë rritje të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, (ii) bashkitë të cilat kanë ulje të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, (iii) bashkitë të cilat kanë rritje të të ardhurave tatimore dhe kanë kompensuar uljen e të ardhurave jo tatimore, (iv) bashkitë të cilat kanë rritje të të ardhurave tatimore, por që nuk kanë mundur të kompensojnë uljen e të ardhurave jo tatimore, (v) bashkitë të cilat kanë ulje të të ardhurave tatimore, por që i kanë kompensuar me rritjen e të ardhurave jo tatimore,

dhe (vi) bashkitë të cilat kanë ulje të të ardhurave tatimore, por që nuk kanë mundur t'i kompensojnë me rritjen e të ardhurave jo tatimore.

Tabela 16: Ndryshimi 2020 - 2019 i të ardhurave të veta, tatimore dhe jo tatimore sipas bashkive

		Tatimore	Jo tatimore	Te ardhurat e veta
I	Delvine, Dropull, Has, Kolonje, Konispol, Kukes, Librazhd, Memaliaj, Patos, Prenjas, Puke, Rogozhine, Sarande, Ura Vajgurore, Vlore	+	+	+
II	Bulqize, Durres, Fier, Fushe Arez, Kamez, Kavaje, Klos, Korce, Kucove, Kurbin, Mallakaster, Mirdite, Selenice, Shijak, Shkoder, Skrapar, Tropoje, Vore	-	-	-
III	Belsh, Berat, Cerik, Finiq, Gramsh, Himare, Lushnje, Malsi e Madhe, Mat, Polican, Tirana	+	-	+
IV	Pogradec, Devoll	+	-	-
V	Maliq, Pustec, Kelcyre, Tepelene	-	+	+
VI	Diber, Divjake, Elbasan, Gjirokaster, Lezhe, Libohove, Peqin, Permet, Roskovec, Vau i Dejes	-	+	-

Vetëm në katër raste dhe në bashki të vogla si bashkia e Maliqit, e Pustecit, e Këlcyrës dhe e Tepelenës, humbjet nga të ardhurat tatimore janë kompensur nga rritja e të ardhurave jo tatimore dhe në total të ardhurat e veta janë me rritje. Ndërsa në dy raste të tjera si në bashkinë e Pogradecit dhe të Devollit, megjithëse të ardhurat tatimore janë në rritje, ulja e të ardhurave jo tatimore ka ndikuar në rezultatin negativ të të ardhurave të veta që në total të jenë më të ulta se në vitin 2019.

Dhe intensiteti i uljes apo i rritjes së të ardhurave të veta është i diferencuar nëpërmjet bashkive. Vërehet se është një numër i konsiderueshëm i bashkive të cilat kanë humbje në një përqindje të lartë të të ardhurave. Në rreth 43% të bashkive kanë një ulje të të ardhurave tatimore nga -20% deri në mbi -40%. Ndërsa janë rreth 25% e bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore në intervalin - 20% deri në -40%. Ndërsa numri i bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore mbi 40% është më i madh se në rastin e uljes së të ardhurave tatimore.

Tabela 17: Ndryshimi në % 2020 - 2019 i të ardhurave tatimore dhe jo tatimore sipas bashkive

	Ulja e të ardhurave të veta			Rritja e të ardhurave të veta		
	deri në -10%	deri në -20%	deri në -40%	deri në 10%	deri në 20%	mbi 40%
Te ardhurat tatimore	Elbasan, Fier, Kruje, Maliq, Shijak, Shkoder, Tepelene	Bulqize, Divjake, Fushe Arez, Gjirokaster, Kelcyre, Korce, Libohove, Permet, Roskovec, Selenice, Skrapar	Diber, Durres, Kamez, Kavaje, Klos, Kucove, Mallakaster, Peqin, Pustec, Tropje, Vau i Dejes, Vore	Finiq, Delvine, Dropull, Librazhd, Lushnje, Malsi e Madhe, Memaliaj, Prenjas, Rrogozhine, Sarande, Tirane, Ura Vajgurore, Vlore	Berat, Cerik, Gramsh, Konispol	Belsh, Kukes, Puke
Te ardhurat jo tatimore	Finiq, Kavaje, Tropoje	Cerik, Durres, Kurbin, Mirdite, Pogradec, Shkoder, Tirane	Fier, Gramsh, Korce, Malsi e Madhe, Mallakaster, Polican, Selenice, Vore	Divjake, Gjirokaster, Lezhe, Permet, Prenjas, Tepelene, Vlore	Diber, Elbasan, Kplonje, Librazhd, Maliq, Patos, Rrogozhine	Delvine, Has, Konispol, Memaliaj, Peqin, Puke, Pustec, Roskovec, Sarande, Vau i Dejes

Dhe në kategoritë e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat ndryshimi është i diferencuar. Janë 31 bashki të cilat kanë ulje të të ardhurave nga pasuria, 33 bashki të cilat kanë ulje nga taksat lokale dhe 28 bashki të cilat kanë ulje të të ardhurave nga biznesi. Intensiteti mesatar i uljes në të ardhurat nga pasuria është -16.1%, dhe nga taksat lokale në -26%. Intensiteti më i lartë i uljes mesatare është tek të ardhurat nga biznesi në -32.4%.

Tabela 18: Ndryshimi në % 2020 - 2019 i të ardhurave tatimore sipas bashkive

	Taksa mbi Pasurine e Palujtshme		Taksa e Biznesit të vogël		Taksa mbi Pasurine e Palujtshme		Taksa e Biznesit të vogël	
	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale	Taksa Lokale
Belsh	71.3	36.5	-20.0	Librazhd	10.9	-5.1	-50.0	
Berat	3.2	14.9	86.8	Lushnje	-0.1	9.2	31.4	
Bulqize	17.6	-17.4	-77.4	M. Madhe	-8.5	11.4	80.0	
Cerik	67.0	-18.4	-55.6	Maliq	-9.3	2.5	20.0	
Delvine	5.7	7.9	6.5	Mallakaster	-23.8	-30.3	50.0	
Devoll	-2.3	45.2	16.7	Mat	33.6	28.8	-40.0	
Diber	-15.6	-26.9	-47.6	Memaliaj	11.4	-50.0	-4.9	
Divjake	-27.6	-3.3	80.0	Mirdite	-10.5	-14.6	-	
Dropull	0.6	20.0	14.9	Patos	76.0	20.5	-7.7	
Durres	-26.2	-24.5	-15.6	Peqin	-29.8	-14.4	-87.5	
Elbasan	8.2	-7.2	1.2	Permet	-23.2	-75.0	-8.2	
Fier	-12.1	-4.3	-2.0	Pogradec	3.8	-1.1	-4.0	
Finiq	-8.1	19.9	-50.0	Polican	-1.1	41.7	19 here	
F. Arez	-15.4	-15.2	100.0	Prenjas	36.7	3.8	-25.0	
Gjirokaster	-12.9	-7.7	-9.8	Puke	107.7	89.6	100.0	
Gramsh	-2.6	18.0	-20.0	Pustec	14.3	-51.9	-	
Has	16.7	18.9	3 here	Rrogozhine	5.6	16.6	-34.9	
Himare	-9.1	41.0	5.7	Roskovec	-13.4	-34.0	5 here	
Kamez	3.1	-42.6	45.8	Sarande	-15.9	9.8	-11.1	
Kavaje	-1.6	-29.8	41.0	Selenice	-4.2	-11.3	-50.0	
Kelcyre	-10.3	100.0	-15.0	Shijak	-90.0	-19.5	20.0	
Klos	0.0	-36.3	75.0	Shkoder	-15.9	-3.5	34.3	
Kolonje	34.4	24.9	0.0	Skrapar	17.6	-21.7	-100.0	
Konispol	26.7	14.3	-66.7	Tepelene	-2.7	46.2	-12.4	
Korce	-7.3	-20.2	4.4	Tirane	51.0	-26.7	0.0	
Kruje	8.9	-6.6	-5.0	Tropoje	41.2	3.2	-30.8	
Kucove	-1.3	-25.9	66.7	U. Vajgurore	12.2	-39.1	116.7	
Kukes	11.0	60.7	-25.0	Vau i Dejes	-28.0	34.7	-16.9	
Kurbin	-28.0	-44.2	0.0	Vlore	-28.5	-46.7	6.7	
Lezhe	17.6	-68.7	25.4	Vore	7.0	0.1	17.1	
Libohove	-13.2	-50.0	-14.3					

Në kategoritë e të ardhurave nga pasuria rënia më e madhe si në numrin e bashkive dhe intensitetin mesatar janë të ardhurat nga taksimi i pasurisë së paluajtshme. Të ardhurat kanë rënie në 35 bashki me një intensitet në ulje në -22.2%. Të ardhurat nga taksimi i tokës bujqësore janë në rënie në 30 bashki me një intensitet në 22%. Të ardhurat nga taksimi i truallit kanë rënie në 17 bashki me një intensitet mesatar të lartë në -33.7%.

Tabela 19: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme

	Toke				Toke		
	Ndertesat	Bujqësore	Trualli		Ndertesat	Bujqësore	Trualli
Belsh	30.4	-13.7	-	Librazhd	2.3	0.0	125.0
Berat	-7.8	28.0	-90.0	Lushnje	-47.1	32.4	11.0
Bulqize	-21.2	-26.3	-	M. Madhe	-17.3	58.3	-
Cerik	1.8	-10.0	66 here	Maliq	8.6	2.5	20.0
Delvine	25.0	-2.2	-	Mallakaster	-24.0	-30.3	50.0
Devoll	-77.3	0.0	16.7	Mat	30.1	28.8	-40.0
Diber	-21.2	-26.3	-	Memaliaj	-50.0	-50.0	-4.9
Divjake	3 here	-21.3	2 here	Mirdite	63.6	-14.6	-
Dropull	-4.8	-10.8	-	Patos	-22.1	20.5	-7.7
Durres	-29.3	-40.0	-	Peqin	-18.8	-14.4	-87.5
Elbasan	9.3	-8.9	11.9	Permet	-11.1	-75.0	-8.2
Fier	-19.8	17.6	-6.3	Pogradec	9.0	-1.1	-4.0
Finiq	-2.9	-10.1	50.0	Polican	-2.5	0.0	-
F. Arez	-17.1	9 here	0.0	Prenjas	32.4	3.8	-25.0
Gjirokaster	13.4	-7.0	-	Puke	107.7	89.6	100.0
Gramsh	-2.6	0.8	-3.7	Pustec	25.0	-51.9	-
Has	40.0	0.0	-	Rrogozhine	5.4	16.6	-34.9
Himare	-7.2	-17.6	-	Roskovec	-83.1	-34.0	5 here
Kamez	9.1	-25.5	-	Sarande	-14.9	9.8	-11.1
Kavaje	1.7	9.4	-	Selenice	-12.5	-11.3	-50.0
Kelcyre	-16.7	9.1	-	Shijak	-2.9	-19.5	20.0
Klos	-5.3	25.0	-	Shkoder	-17.3	-3.5	34.3
Kolonje	-25.0	102.4	-	Skrapar	-3.8	-21.7	-100.0
Konispol	-6.9	80.9	0.0	Tepelene	-17.4	46.2	-12.4
Korce	-3.1	1.7	-	Tirane	4.4	1.4	3 here
Kruje	12.6	-20.0	-	Tropoje	25.0	-	100.0
Kucove	4.7	-10.6	-	U. Vajgurore	29.4	2.6	-10.3
Kukes	11.1	9 here	-	Vau i Dejes	-26.0	-31.6	-
Kurbini	-34.9	-45.5	-	Vlore	-35.1	18.0	3.7
Lezhe	21.9	21.1	-	Vore	1.2	29.3	-78.1
Libohove	-16.7	-5.3	-				

Në kategorinë e të ardhurave nga taksat lokale, taksa e ndikimit në infrastrukturë ka ulje në 37 bashki ose në mbi 60% të tyre, me një intensitet të lartë mesatar të uljes së të ardhurave në rreth -44%. Të ardhurat e përkohëshme dhe të tjera kanë rënie në 27 bashki me një intensitet mesatar në -25%.

Taksa e tabelës ka treguar ulje në 26 bashki me intensitetin mesatar të uljes në -52%. Ndërsa të ardhurat nga taksa e fjetjesne hotel kanë rënie në një numër më të vogël të bashkive gjithsej në 25, por një intensitet të uljes së tyre shumë të lartë në -51.1%.

Tabela 20: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave lokale tatimore sipas bashkive

	Ndikimi ne infrastruktura	Fjetjes ne Hotel	Tabeles	Tjera		Ndikimi ne infrastruktura	Fjetjes ne Hotel	Tabeles	Tjera
Belsh	-37.0	-	6 here	18.0	Librazhd	-56.0	12 here	0.0	0.0
Berat	-74.0	-84.0	5.0	71.0	Lushnje	78.5	-33.3	-9.3	2.4
Bulqize	-12.0	-	100.0	-57.0	M. Madhe	81.5	0.0	0.0	8.6
Cerik	-51.0	-	-20.0	-21.0	Maliq	94.1	-	0.0	21.0
Delvine	-28.0	-	0.0	21.6	Mallakaster	15.3	-	-40.0	-36.0
Devoll	-7.9	-	-50.0	-5.3	Mat	-62.0	-	-33.0	53.0
Diber	-4.0	-40.0	6 here	-49.0	Memaliaj	-	-	2 here	-22.6
Divjake	38.5	-83.3	-50.0	-11.2	Mirdite	4.9	-	-30.0	16.7
Dropull	31.1	100.0	-	16.5	Patos	-9.0	-	0.0	-42.0
Durres	-25.0	-76.0	-14.0	-9.0	Peqin	-52.0	-	38.0	20.0
Elbasan	-14.0	-71.0	-14.0	7.0	Permet	-43.2	0.0	25.0	-7.3
Fier	-53.5	-66.7	2 here	69.5	Pogradec	-30.0	-50.0	-50.0	51.4
Finiq	94.1	-	0.0	21.0	Polican	2 here	-	0.0	124.0
F. Arez	-90.0	-	-	-13.0	Prenjas	-37.0	-	38.0	-25.0
Gjirokaster	-57.7	-55.6	-	-5.3	Puke	28.6	0.0	133.3	17.0
Gramsh	86.0	0.0	0.0	15.0	Pustec	31.8	-53.6	83.3	-20.7
Has	133.3	-	-50.0	-1.9	Rrogozhine	78.0	-2.3	75.0	14.0
Himare	111.0	-21.4	0.0	21.6	Roskovec	8.0	-	2 here	37.0
Kamez	-21.0	100.0	-20.0	-72.0	Sarande	31.8	-53.6	83.3	-20.7
Kavaje	-48.0	-44.0	3.0	3.0	Selenice	-7.9	-	-50.0	-5.3
Kelcyre	3 here	-	-50.0	-16.7	Shijak	-49.0	-	-13.0	-80.0
Klos	-86.0	-	-67.0	29.0	Shkoder	1.0	-62.6	-9.6	6.0
Kolonje	-28.0	-	0.0	21.6	Skrapar	-83.0	-8.0	5.0	-26.0
Konispol	-30.0	-50.0	-50.0	56.4	Tepelene	-17.5	-	-40.0	-22.2
Korce	192.0	-15.4	0.0	1.3	Tirane	2.0	-68.0	-10.0	-5.0
Kruje	-78.0	-67.0	-6.0	35.0	Tropoje	-78.5	-50.0	150.0	37.3
Kucove	-	-100.0	0.0	-21.7	U. Vajgurore	-12.0	50.0	2.0	3.0
Kukes	-16.1	-50.0	2 here	3 here	Vau i Dejes	-78.4	-	0.0	-20.1
Kurbin	-71.4	-	0.0	-12.6	Vlore	2 here	-15.4	0.0	1.3
Lezhe	-92.1	-42.6	-46.2	-43.1	Vore	-68.0	-96.0	-20.0	0.0
Libohove	-9.1	-	-	-					

Të ardhurat nga tarifat e zënies së hapësirës publike janë ulur në 35 bashki me një intensitet mesatar të uljes në -44%. Të ardhurat nga tarifat e pastrimit janë ulur në 29 bashki me një intensitet mesatar më të ulët në -21%. Ndërsa të ardhurat nga tarifa e gjelbërimit janë ulur në 24 bashki me një intensitet mesatar të uljes në -28.4%.

Tabela 21: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i të ardhurave lokale tarifore sipas bashkive

	Tarifa e zënies se hapsires			Tarifa e zënies se hapsires			
	publike	Tarifa e pastrimit	Tarifa e gjelberimit	publike	Tarifa e pastrimit	Tarifa e gjelberimit	
Belsh	-40,0	2 here	2 here	Librazhd	48,0	21,2	-38,0
Berat	-34,0	16,2	113,3	Lushnje	-35,3	-5,2	-
Bulqize	-	9,9	-	M. Madhe	-90,0	-21,6	-20,0
Cerik	0,0	16,9	11,1	Maliq	-	-7,1	-
Delvine	-50,0	-	-	Mallakaster	-37,5	7,3	-45,9
Devoll	-70,0	-11,1	-72,5	Mat	100,0	-	-
Diber	-80,0	22,6	-25,0	Memaliaj	0,0	-16,7	0,0
Divjake	45,2	-22,6	-25,0	Mirdite	-9,0	-36,4	-
Dropull	-	0,0	-	Patos	-25,0	4,9	-23,5
Durres	-32,8	-33,7	-28,7	Peqin	4 here	-10,1	-
Elbasan	-25,8	-11,1	-1,1	Permet	75,0	1,3	-
Fier	30,2	-57,6	-66,7	Pogradec	-60,0	-9,1	-
Finiq	-	-7,1	-	Polican	-9,4	12,3	-16,7
F. Arez	3 here	7,1	-	Prenjas	-25,0	34,0	33,3
Gjirokastr	50,0	-5,5	-	Puke	0,0	53,5	-
Gramsh	-21,4	-	-23,1	Pustec	36,3	1,6	0,0
Has	0,0	44,4	100,0	Rrogozhine	3,4	29,6	4,0
Himare	-6,3	-16,7	-18,1	Roskovec	25,0	-99,2	83,3
Kamez	-60,0	17,0	16,4	Sarande	36,3	1,6	0,0
Kavaje	-13,8	13,9	-	Selenice	-70,0	-11,1	-72,5
Kelcyre	-60,0	-20,0	-	Shijak	-80,0	46,6	-
Klos	-	-	-	Shkoder	-53,2	-10,7	-10,8
Kolonje	-50,0	-	-	Skrapar	0,0	-1,4	-44,4
Konispol	-60,0	-9,1	-	Tepelene	-11,1	17,4	0,0
Korce	-32,0	-19,0	-	Tirane	-94,1	9,6	-
Kruje	-	-47,2	-96,7	Tropoje	-50,0	2,0	-
Kucove	-21,7	-4,3	-	U. Vajgurore	-16,7	9,5	16,3
Kukes	34 here	4,7	29 here	Vau i Dejes	-	-46,3	-4,2
Kurbin	-90,0	-21,6	-20,0	Vlore	-32,0	-19,0	-
Lezhe	-53,2	-10,7	-10,8	Vore	0,0	9,5	-
Libohove	100,0	-12,5	-				

16. Burimet e financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore në vitin 2020

Të ballafaquar me realitetin e krizës dhe nevojën për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për mbrojtjen dhe parandalimin e pandemisë, këshillat bashkiake rishikuan buxhetet e tyre për të bërë një parashikim më realist të mbledhjes së të ardhurave. Gjithashtu këshillat bashkiake duke e konsideruar nevojën në rritje të burimeve financiare për të mbuluar kategori të caktuara të shpenzimeve lidhur me pandeminë, vendosën rishpërndarjen e buxhetit ndërmjet linjave buxhetore, përdorimin e fondeve të emergjencës, përdorimin e fondeve të mbartura nga vitet e kaluara si nga transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, kontributet nga niveli qendror i qeverisjes apo dhe nga donatorët ndërkombëtarë.

Ne Aktin Normativ Nr 34, datë 16.12.2020 reflektohet ndryshimi në burimet e financimit të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e veta si dhe të financimit të huaj janë rishikuar në ulje. Ndërsa transfertat e pakushtëzuar si dhe taksat e ndara janë rishikuar në rritje. Për të treguar efektin negativ në ndryshimin e nivelit të burimeve të financimit është krahasuar niveli i realizimit të tyre me buxhetin e miratuar dhe me nivelin e financimit në vitin 2019.

Tabela 22: Burimet e financimit të buxhetit vendor në miliard lekë

Në miliard lekë	Realizim 2019	Buxheti i miratuar 2020	2020 Buxheti AN Nr 34	Realizim 2020	Ndryshim 2020/19 në %
Transferta e pakushtëzuar	26.80	26.04	26.10	25.00	-6.7
Të ardhurat e veta	25.61	29.84	25.85	24.17	-5.6
Të ardhurat e veta të mbartura	2.50	-	-	1.97	-
Taksat e ndara	n.a.	0.67	0.80	n.a.	-
Financimi i huaj	1.23	1.00	0.53	0.28	-77.2
Të ardhura jashtë limitit	0.06	-	-	0.18	-
Totali	56.20	57.55	53.28	51.60	-8.2

Të ardhurat e veta janë në ulje në -5.6% dhe financimi i huaj në -77.2% krahasuar me vitin 2019. Transferta e pakushtëzuar e miratuar në buxhetin vendor të vitit 2020 nuk është përdorur plotësisht. Por në krahasim me vitin 2019 transferta e pakushtëzuar e përdorur mbetet më e ulët në nivelin -6.7%. Arsyeja e këtij mos realizimi mund të jetë pamundësia për të mos lejuar kalimin nga një sektor në tjetrin të transfertës të pakushtëzuara sektoriale për tu përdorur në atë sektor ku nevoja ka qënë më emergjente¹⁰. Në vitin 2020 pavarësisht përdorimit të fondeve të mbartura apo rritjes së të ardhurave jashtë limitit, totali i burimeve të financimit është 4.6 miliard lekë më i ulët ose -8.2% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 23: Transferta e pakushtëzuar 2020, në miliard lekë

Nr.	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2020	Shtesë nga Kuvendi, "Transfertë e pakushtëzuar për vitin 2020"	Transferrat e pakushtëzuara sektoriale											Totali	
			Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor		Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe Kullimi	Klubet shumësportësh dhe "Partizani dhe "Studenti"	Shtesë nga Kuvendi "Transfertë e pakushtëzuar sektoriale për investime në rrugë"		
				Ndarë me formulë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës										
1	Bashkite	15,91	0,20	0,52	4,04	1,03	0,48	1,15	0,13	0,32	0,52	0,86	0,03	0,20	25,39
2	K. Qarqeve	0,55													0,55
3	Totali	15,91	0,20	0,52	4,04	1,03	0,48	1,15	0,13	0,32	0,52	0,86	0,03	0,20	25,94

Rënia e të ardhurave të veta ka qënë e mundur në disa raste të kompensohej me rritjen e përdorimit të transfertës. Kompensimi i plotë ose i pjesshëm i burimeve të financimit është i mundshëm për sa kohë pesha e dy burimeve të financimit në nivel agregat është pothuajse e barabartë. Ecuria e burimeve të financimit mbetet e diferencuar ndërmjet bashkive.

Nga pikëpamja e ndryshimit të burimeve të financimit bashkitë janë ndarë në gjashtë kategori. Kategoria e parë e bashkive është ajo të cilave nuk u janë rritur burimet e financimit si nga përdorimi i të ardhurave nga transferta dhe nga të ardhurat e veta. Kategoria e dytë e bashkive janë ato të cilat kanë ulje të përdorimit të transfertës dhe të të ardhurave të veta.

¹⁰ Për shkak të masave të ndërmara për mbylljen e aktivitetit të institucioneve të arsimit parashkollor, të arsimit parauniversitar, të konvikteve një pjesë e shpenzimeve të planifikuara nga transferta e pakushtëzuar sektoriale nuk ka qënë e mundur të realizohej dhe si rezultat një pjesë e këtyre fondeve nuk janë përdorur.

Kategoria e tretë e bashkive janë ato të cilat kanë rritje të përdorimit të transfertës dhe që ka kompensuar dhe uljen e të ardhurave të veta. Kategoria e katërt e bashkive janë ato të cilat pavarësisht rritjes së përdorimit të transfertës nuk kanë mundur të kompensojnë uljen e të ardhurave të veta dhe si rrjedhim totali i burimeve financiare është në ulje.

Kategoria e pestë e bashkive janë ato të cilat uljen e përdorimit të transfertës e kanë kompensuar me rritjen e të ardhurave dhe burimi i financimit të bashkive është në rritje në vitin 2020. Kategoria e fundit e bashkive janë ato të cilat rritjen e të ardhurave të veta nuk e kanë kompensuar me uljen e përdorimit të transfertës dhe burimi i financimit është në ulje për vitin 2020.

Tabela 24: Ndryshimi 2020 - 2019 i përdorimit të transfertës, dhe i të ardhurave të veta sipas bashkive

		Transferta	Te ardhurat e veta	Totali i te ardhurave
I	Belsh, Prenjas, Gramsh, Kolonje, Kukes, Ura Vajgurore, Rrogozhine, Pustec, Malsi e Madhe	+	+	+
II	Kamez, Kavaje, Vore, Kucove, Diber, Bulqize, Klos, Durres, Kruje, Peqin, Fier, Divjak, Roskovec, Gjirokaster, Lezhe, Kurbin, Korce, Devoll, Tropoje, Shkoder, Selenice	-	-	-
III	Skrapar, Shijak, Elbasan, Permet, Librazhd, Libohove	+	-	+
IV	Mallakaster, Mirdite, Vau i Dejes, Fushe Arez	+	-	-
V	Polican, Puke, Himare, Konispol	-	+	+
VI	Tiran, Berat, Mat, Librazhd, Cerik, Lushnje, Patos, Memaliaj, Kelcyre, Tepelene, Dropull, Maliq, Has, Vlore, Delvine, Finiq	-	+	-

Nga analiza rezultojnë se 68% e bashkive në vitin 2020 kanë rezultuar me ulje të burimit të financimit. Rreth 16% e bashkive kanë treguar rritje të transfertës dhe të të ardhurave të veta duke pasur një rezultat pozitiv në rritje në vitin 2020 të burimit të financimit krahasuar me vitin 2019. Rreth 10% e bashkive kanë mundur të kompensojnë uljen e të ardhurave të veta nga rritja e përdorimit të transfertës, dhe rreth 7% e bashkive kanë arritur të kompensojnë uljen e përdorimit të transfertës nga rritja e të ardhurave dhe të kenë një rezultat pozitiv të burimit të financimit. Rreth 7% të bashkive nuk kanë mundur të kompensojnë rritjen e përdorimit të transfertës me uljen e të ardhurave të veta. Dhe rreth 26% e bashkive nuk kanë mundur të kompensojnë uljen e përdorimit të transfertës me rritjen e të ardhurave të veta.

Tabela 25: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i përdorimit të transfertës dhe i të ardhurave të veta sipas bashkive

	Te ardhurat e veta			Te ardhurat e veta	
	Transferta	veta		Transferta	e veta
Belsh	3,4	22,6	Librazhd	-7,1	3,2
Berat	-16,7	4,0	Lushnje	-4,1	0,2
Bulqize	-12,7	-15,2	M. Madhe	2,0	3,2
Cerik	-12,0	8,9	Maliq	-6,8	0,3
Delvine	-7,2	18,0	Mallakaster	15,0	-28,3
Devoll	-22,2	-7,7	Mat	-5,3	18,9
Diber	-0,3	-17,8	Memaliaj	-16,9	21,7
Divjake	-0,9	-10,0	Mirdite	8,1	-16,6
Dropull	-10,9	11,4	Patos	-25,1	33,2
Durres	-3,5	-23,8	Peqin	-2,0	-20,3
Elbasan	1,8	-1,8	Permet	3,0	-10,9
Fier	-0,4	-9,4	Pogradec	-8,0	-0,3
Finiq	-23,0	2,8	Polican	-0,7	13,4
F. Arez	7,5	-32,7	Prenjas	-22,3	6,6
Gjirokaster	-11,9	-7,5	Puke	-8,3	93,4
Gramsh	16,0	3,7	Pustec	0,4	10,8
Has	-8,5	20,5	Rrogozhine	57,3	24,8
Himare	-13,3	25,5	Roskovec	-0,7	-15,4
Kamez	-11,2	-37,4	Sarande	-28,3	5,4
Kavaje	-9,5	-21,7	Selenice	-11,1	-12,0
Kelcyre	-14,9	7,0	Shijak	11,0	-8,9
Klos	-22,4	-27,2	Shkoder	-11,9	-7,3
Kolonje	7,4	21,0	Skrapar	35,5	-37,4
Konispol	-2,5	31,8	Tepelene	-0,4	0,6
Korce	-11,7	-17,8	Tirane	-18,6	0,0
Kruje	-11,3	-13,5	Tropoje	-9,5	-19,8
Kucove	-8,1	-22,5	U. Vajguror	7,7	7,1
Kukes	3,1	36,0	Vau i Dejes	9,4	-32,2
Kurbin	-1,7	-36,0	Vlore	-4,4	4,8
Lezhe	-4,7	-56,9	Vore	-18,8	-28,7
Libohove	9,6	-13,2			

Një tregues tjetër është ai i intensitetit të zvoglimit apo rritjes së burimeve të financimit. Ndarja e bashkive është bërë në tre grupe. Në grupin e parë janë bashkitë të cilave i është ulur transferta në masën -10% si dhe bashkitë të cilave të ardhurat e veta i janë zvogluar po -10%. Në grupin e dytë janë bashkitë të cilave ulja e përdorimit të transfertës dhe e të ardhurave të veta është më e lartë deri në -20%.

Bashkitë me mungesë fondesh janë ato të cilat si përdorimi i transfertës dhe mbledhja e të ardhurave është ulur deri në -40%. Rreth 67% e bashkive u është ulur përdorimi i transfertës, dhe rreth 50% e tyre u janë ulur të ardhurat e veta. Bashkitë të cilat kanë pasur ulje të lartë nga -20 deri në -40% të transfertës janë rreth 28% e numrit të përgjithshëm. Ndërsa bashkitë të cilave u janë ulur të ardhurat e veta nga -20 deri në -40% janë rreth 34%.

Tabela 26: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 i burimeve të financimit sipas bashkive

	Ulja e burimit të financimit			Rritja e burimit të financimit		
	deri në -10%	deri në -20%	deri në -40%	deri në 10%	deri në 20%	deri në 40%
Transferta	Delvine, Diber, Divjake, Durres, Fier, Has, Kavaje, Konispol, Kucove, Kurbin, Lezhem, Librazhd, Lushnje, Maliq, Mat, Peqin, Pogradec, Polican, Puke, Roskovec, Tepelene, Tropoje, Vlore	Berat, Bulqize, Cerik, Dropull, Gjirokaster, Himare, Kamez, Kolonje, Korce, Kruje, Memaliaj, Selenice, Tirane, Vore	Devoll, Finiq, Patos, Prenjas, Sarande	Fushe Arez, Kolonje, Libohove, Malsi e Madhe, Permet, Pustec, Ure Vajgurore, Vau i Dejes	Gramsh, Mallakaster, Shijak	Rrogozhine, Skrapar
Te ardhurat e veta	Devoll, Divjake, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Shkoder, Pogradec	Bulqize, Diber, Korce, Kruje, Libohove, Tropoje, Selenice, Roskovec, Peqin, Mirdite	Fushe Arez, Kamez, Durres, Kavaje, Klos, Kucove, Vore, Mallakaster, Vau i Dejes, Kurbin, Lezhe, Skrapar	Finiq, Gramsh, Kelcyre, Vlore, Ura Vajgurore, Tepelene, Sarande, Prenjas, Malsi e Madhe, Lushnje, Librazhd	Cerik, Dropull, Has, Pustec, Polican, Mat	Belsh, Rrogozhine, Himare, Kolonje, Konispol, Kukes

Përveç efektit negativ në nivel agregat dhe vjetor, njesitë e vetëqeverisjes vendore kanë pasur mangësi të burimeve të financimit ose të likuiditetit gjatë vitit fiskal, në veçanti në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit. Të ardhurat fiskale në tremujorin e parë të vitit 2020 janë rreth 1 miliard lekë më pak se në të njëjtin tremujor të vitit 2019. Ndërsa në tremujorin e dytë kjo diferencë është thelluar më shumë në 3.3 miliard lekë.

Tabela 27: Dinamika e të ardhurave fiskale vendore kumulative në miliard lekë 2020 – 2019

në miliard lekë	Totali i të ardhurave fiskale		Te ardhurat nga taksat lokale		Te ardhurat nga pasuria		Biznesi i vogël	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020		
Janar	1,4	1,2	1,1	0,9	0,2	0,3	0,0	0,0
Shkurt	3,2	2,9	2,7	2,4	0,4	0,6	0,0	0,0
Mars	4,9	4,0	4,1	3,0	0,8	0,8	0,0	0,2
Prill	9,6	5,7	7,1	4,3	2,3	1,1	0,2	0,3
Maj	11,3	7,0	8,4	5,3	2,7	1,4	0,3	0,3
Qershor	13,5	10,2	10,5	7,7	3,1	2,2	0,3	0,3
Korrik	15,2	13,1	11,4	9,7	3,5	3,0	0,3	0,4
Gusht	17,3	14,9	13,1	11,1	3,8	3,5	0,3	0,4
Shtator	18,9	16,7	14,5	12,5	4,2	3,9	0,3	0,4
Tetor	20,7	18,5	15,9	13,8	4,5	4,3	0,3	0,4
Nendor	21,8	19,8	16,7	14,8	4,8	4,7	0,3	0,4
Dhjetor	23,1	21,9	17,5	16,5	5,2	5,1	0,4	0,4

Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

17. Efekti mbi shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore

Përgjigja ndaj krizës COVID-19 dhe masat për parandalimin e saj kërkuan më shumë burime financiare. Ndërsa qeveria qendrore është përgjegjëse për menaxhimin e krizës, njesitë e vetëqeverisjes vendore përgjigjen për marrjen e masave të përditshme të shërbimeve publike, të kujdesit shëndetësor, arsimor, të kujdesit dhe shërbimit social, avancimit të zhvillimit ekonomik dhe investimet publike lokale.

Në situatën e krijuar burimet financiare për të përballuar nevojat në rritje ishin të pamjaftueshme, veçanërisht për shpërndarjen e furnizimeve ushqimore dhe jo ushqimore, për të financuar shpenzimet emergjente si blerja e ushqimit dhe furnizimeve jo ushqimore, pagesa për dezinfektimin e hapësirave dhe objekteve publike, të tregut, blerja e materialeve të disponueshme për punonjësit, etj.

Shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore u tkurrën në vitin 2020 në raport me vitin 2019 në rreth 4.6 miliard lekë. Dinamika në ulje e shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore u diktua si rezultat i tkurrjes e të ardhurave të veta, të mos rritjes së nivelit të transfertës të pakushtëzuar, të mos lejimit të transfertës të pakushtëzuar sektoriale për tu përdorur nga sektorë ku nuk ka qënë e mundur të përdorej në sektor ku nevoja ka qënë më emergjente, etj. Si rezultat i burimeve financiare të pamjaftueshme për të përballuar nevojat e krizës së pandemisë, bashkitë vendosën rialokimin e shpenzimeve dhe veçanërisht të shpenzimeve të personelit dhe në një masë të madhe të shpenzimeve kapitale në shpenzime operative të nevojshme për të përballuar krizën.


Megjithatë dinamika e shpenzimeve mbeti e diferencuar si në nivel të qarkut dhe në nivel të bashkive si për shpenzimet totale, dhe sipas kategorive ekonomike. Ecuria e shpenzimeve në vitin 2020 në nivel agregat, në nivel qarku dhe në nivel të bashkive është analizuar duke e krahasuar me vitin 2019.

Në shpenzimet totale në nivel agregat, shpenzimet e personelit zënë 43%, shpenzimet korente zënë 32% dhe shpenzimet kapitale zënë 25%. Shpenzimet totale në nivel agregat janë ulur në -8.1%, shpenzimet e personelit janë rritur në 2.5%, shpenzimet korente në -1.1% dhe -27.8%. Tkurrjen më të lartë e kanë pasur shpenzimet kapitale në -27.8%. Ecuria e shpenzimeve kapitale ka përcaktuar dhe dinamikën e shpenzimeve totale.

Tabela 28: Shpenzimet e buxhetit vendor në miliard lekë

	2019	2020	Ndryshimi ne %
Shpenzimet e personelit	21,84	22,39	2,5
Shpenzimet operative	16,51	16,33	-1,1
Shpenzimet kapitale	17,88	12,91	-27,8
Shpenzimet totale	56,2	51,6	-8,1

Grafiku 2 : Shpenzimet e buxhetit vendor në miliard lekë dhe ndryshimi në përqindje 2020-2019



Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

Në nivel të qarqeve ndryshimi i shpenzimeve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është e diferencuar. Shpenzimet totale të njërive të vetëqeverisjes vendore janë ulur në të gjitha qarqet, me përjashtim të qarkut të Elbasanit. Shpenzimet kapitale janë ulur te të gjitha bashkitë si rezultat kryesisht të rialokimit të tyre në shpenzimet e personelit dhe ato operative.


Qarqet si Tirana, Elbasani dhe Korça kanë rialokuar shpenzimet kapitale në shpenzimet e personelit dhe operative duke siguruar një rritje positive të këtyre kategorive të shpenzimeve. Qarqet e tjera pavarësisht tkurrjes së shpenzimeve kapitale kanë mundur të plotësojnë pjesërisht nevojat në rritje për shpenzimet e personelit dhe ato operative. Tkurrjen më të lartë të shpenzimeve kapitale e kanë qarku i Korçës në -48%, qarku i Lezhës në -47.4%, qarku i Shkodrës në -47.4% dhe qarku i Fierit në -40%.

Tabela 29: Ndryshimi në përqindje 2020-2019 i shpenzimeve vendore sipas qarqeve

	Totale	Personeli	Operative	Kapitale
Tirana	-7,8	5,6	0,8	-22,8
Berati	-0,9	-1,2	23,3	-27,2
Diber	-7,9	-2,8	6,0	-37,0
Durresi	-14,8	0,7	-11,5	-36,3
Elbasan	2,0	2,0	6,0	-10,0
Fier	-13,0	1,0	-5,0	-40,0
Gjirokaster	-6,8	-0,1	-6,3	-37,5
Lezhe	-17,1	-7,5	-10,4	-47,4
Korce	-5,0	6,0	11,0	-48,0
Kukes	-3,0	3,0	-15,0	-7,0
Shkoder	-17,0	4,0	-10,0	-47,0
Vlore	-3,0	5,0	-8,0	-11,0

Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

Grafiku 21: Ndryshimi në përqindje 2020-2019 i shpenzimeve vendore sipas qarqeve



Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

Në nivel të bashkive ndryshimi në përqindje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është shumë më i diferencuar. Janë 24 bashki të cilat kanë treguar ulje të shpenzimeve të personelit dhe 37 të tjera të cilat i kanë rritur shpenzimet e personelit. Janë 32 bashki të cilat kanë ulur shpenzimet korente dhe 29 të cilat i kanë rritur. Dhe së fundmi janë 43 bashki të cilat i kanë ulur shpenzimet kapitale dhe 18 bashki të cilat i kanë rritur ato. Dhe intensiteti i uljes së shpenzimeve sipas kategorive nuk është i njëjtë.

Tabela 30: Ndryshimi 2020-2019 i shpenzimeve vendore

Emërtimi	Ndryshimi 20/19 ne ulje (-)	Ndryshimi 20/19 në rritje (+)
Shpenzimet e personelit	24	37
Shpenzimet korente	32	29
Shpenzimet kapitale	43	18

Në nivel të bashkive tkurrja e shpenzimeve në total dhe sipas kategorive të shpenzimeve është më e diferencuar. Bashkitë më të mëdha në popullsi si Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora kanë tkurrjen më të madhe, dhe veçanërisht në shpenzimet kapitale duke i alokuar fondet për të mbuluar nevojat për shpenzime shtesë të personelit dhe ato operative. Tkurrja e investimeve për shtatë bashkitë e mësipërme është rreth -32.2% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Grafiku 22: Ndryshimi i shpenzimeve i bashkive në përqindje 2020 - 2019




Tabela 31: Ndryshimi në përqindje 2020 - 2019 e shpenzimeve vendore sipas bashkive

	Shpenzimet totale			Shpenzimet personeli			Shpenzimet korente			Shpenzimet kapitale		
	2019	2020	Ne %	2019	2020	Ne %	2019	2020	Ne %	2019	2020	Ne %
K.e Qarkut	676	637	-5,8	199	196	-1,5	198	158	-20,2	277	283	2,2
Tiranë	19.404	18.220	-6,1	5.026	5.323	5,9	6.331	6.557	3,6	8.047	6.340	-21,2
Berat	904	838	-7,3	480	466	-2,9	179	261	45,9	245	111	-54,6
Bulqize	576	465	-19,2	221	230	4,1	133	133	-0,5	222	103	-53,7
Delvine	164	163	-0,7	103	102	-1,1	28	39	39,4	33	22	-33,4
Devoll	445	412	-7,4	168	183	8,5	169	177	5,1	108	52	-51,6
Diber	719	730	1,5	501	479	-4,3	157	170	8,7	62	80	30,7
Durres	2.889	2.431	-15,8	1.138	1.149	0,9	682	624	-8,5	1.069	658	-38,4
Shijak	347	348	0,3	161	169	5,0	136	105	-22,5	50	74	46,6
Elbasan	1.853	1.783	-3,8	959	967	0,9	550	566	2,9	344	250	-27,2
Cerrik	350	320	-8,5	185	167	-9,6	76	87	13,9	89	66	-25,3
Fier	1.734	1.598	-7,8	795	796	0,1	532	544	2,2	406	259	-36,4
Patos	476	386	-18,9	206	205	-0,1	81	76	-6,3	192	104	-45,6
Roskovec	416	370	-10,9	185	183	-1,2	72	71	-1,0	159	117	-26,7
Gramsh	468	509	8,8	211	219	3,6	112	112	-0,2	145	176	21,8
Gjirokastrë	592	523	-11,6	375	362	-3,5	154	133	-14,2	62	28	-54,8
Libohovë	87	91	4,7	54	56	4,1	21	28	33,5	12	7	-40,2
Has	263	248	-5,9	143	156	9,0	66	58	-11,7	54	33	-38,0
Kavaja	802	710	-11,5	391	386	-1,3	246	180	-26,7	165	144	-12,8
Rogozhine	309	456	47,6	156	187	19,7	107	96	-10,3	45	173	287,0
Kolonje	252	280	10,9	172	162	-5,9	59	77	30,8	21	41	91,1
Korçe	1.521	1.310	-13,9	594	607	2,1	579	545	-5,9	348	158	-54,6
Krujë	754	619	-17,9	363	356	-1,8	157	134	-14,8	234	129	-44,8
Kucove	424	372	-12,2	228	224	-1,9	135	127	-6,1	61	21	-64,8
Kukes	612	649	6,1	422	430	1,9	188	176	-6,4	2	44	1971,4
Kurbini	445	415	-6,9	235	233	-0,8	150	169	12,3	60	13	-78,8
Lezhe	1.219	889	-27,0	528	450	-14,7	368	260	-29,4	323	179	-44,4
Librazhd	582	540	-7,2	250	238	-4,8	144	151	4,9	188	151	-19,7
Lushnje	1.096	1.070	-2,4	541	563	4,2	332	327	-1,4	224	180	-19,6
Malesi e Madhe	539	435	-19,3	224	232	3,5	87	88	0,1	227	115	-49,4
Mallakaster	694	383	-44,9	229	227	-1,1	143	102	-28,6	322	54	-83,3
Mat	450	444	-1,4	261	258	-1,2	118	129	9,6	72	57	-20,5
Mirdite	407	413	1,6	250	253	1,4	87	114	30,8	70	46	-34,0
Peqin	228	273	19,8	145	169	16,7	94	87	-7,9	39	17	-56,2
Permet	234	238	1,9	153	153	-0,3	48	50	4,8	33	36	8,2
Pogradec	825	872	5,7	369	446	21,0	192	324	68,7	264	102	-61,4
Puke	220	243	10,5	159	159	-0,2	53	48	-9,5	8	36	346,9
Sarandë	684	644	-5,9	242	260	7,6	265	206	-22,3	176	177	0,3
Skrapar	268	333	24,1	209	202	-3,4	50	64	28,1	9	67	638,9
Polican	182	184	1,5	130	120	-7,6	41	51	23,2	11	14	30,2
Shkoder	1.978	1.664	-15,9	615	621	0,9	770	671	-12,9	593	373	-37,2
Tepelene	199	199	0,3	140	141	1,0	51	53	4,5	9	5	-38,6
Memaliaj	206	167	-18,8	116	118	1,8	46	43	-6,5	44	6	-86,2
Tropoje	333	274	-17,5	196	197	0,5	81	51	-36,8	56	27	-50,9
Vlore	1.686	1.657	-1,7	664	734	10,4	833	765	-8,2	189	169	-10,5
Divjake	441	442	0,2	234	237	1,3	115	87	-24,1	93	118	27,7
Belsh	230	285	23,5	115	145	26,3	49	63	28,0	66	76	15,2
Prrenjas	268	341	27,4	171	180	5,1	49	73	46,8	48	89	86,8
Kelcyre	141	121	-14,0	85	84	-1,3	33	27	-19,3	22	10	-55,0
Fushë-Arrez	170	195	14,8	124	126	1,8	23	28	20,3	23	42	80,3
Konispol	139	145	4,4	71	72	2,3	49	56	14,8	19	16	-14,6
Vau Dejës	647	403	-37,8	199	236	18,9	102	102	-0,1	346	64	-81,4
Selenice	320	290	-9,3	152	154	1,1	61	76	23,9	107	61	-43,0
Himare	343	368	7,3	117	116	-0,8	143	133	-7,1	84	120	44,1
Vorë	616	344	-44,2	207	209	1,0	141	72	-49,2	268	63	-76,5
Kamëz	1.637	1.264	-22,8	401	423	5,6	241	214	-10,9	996	626	-37,1
Ura Vajgurore	342	373	9,0	153	174	13,6	80	95	19,4	109	103	-5,1
Maliq	590	557	-5,7	312	319	2,2	141	147	4,1	138	92	-33,5
Finiq	304	250	-17,8	145	128	-11,7	71	73	2,0	88	49	-44,2
Dropull	158	167	5,4	76	84	9,8	41	36	-12,6	41	47	15,6
Pustec	61	66	8,0	38	41	7,0	15	13	-15,0	8	12	57,0
Klos	264	211	-20,0	148	132	-11,0	51	55	6,6	64	24	-62,1
Totali	56.176	51.624	-8,1	21.837	22.391	2,5	16.505	16.332	-1,1	17.884	12.912	-27,8

Një tregues tjetër i efektit mbi shpenzimet është ai i intensitetit mesatar i uljes së shpenzimeve sipas kategorive për bashkitë të cilat kanë treguar ulje të këtyre shpenzimeve. Intensiteti mesatar i uljes së shpenzimeve të personelit është -3.8%, i shpenzimeve korente është -13.6%.

Ndërsa intensiteti mesatar i uljes së shpenzimeve kapitale është -43.4%. Janë 15 bashki si ajo e Beratit, Bulqizës, Devollit, Gjirokastrës, Korçës, Kurbinit, Mallakastrës, Peqinit, Pogradecit, Memaliajt, Tropjës, Këlcyrës, Vaut të Dejës, Vorës, dhe e Klosit, të cilat kanë ulje të shpenzimeve kapitale mbi -50%.

Tabela 32: Intensiteti i ndryshimit 2020 - 2019 i shpenzimeve vendore sipas bashkive


Bashkite me ulje te shpenzimeve sipas kategorive	Intesiteti mesatar i uljes se shpenzimeve ne %		
	Personelit	Korente	Kapitale
Berat, Delvine, Diber, Cerrik, Patos, Roskovec, Gjirokaster, Kavaje, Kolonje, Kruje, Kucove, Kurbin, Lezhe, Librazhd, Mallakster, Mat, Permet, Puke, Skrapar, Polican, Kelcyre, Himare, Finiq, Klos	-3,8		
Bulqize, Durres, Shijak, Patos, Roskovec, Gramsh, Gjirokaster, Has, Kavaje, Rrogozhine, Korce, Kruje, Kucove, Kukes, Lezhe, Librazhd, Mallakaster, Peqin, Puke, Sarande, Shkoder, Memaliaj, Tropoje, Vlore, Divjake, Kelcyre, Vau i Dejes, Himare, Vore, Kamez, Dropull, Pustec		-13,6	
Tirane, Berat, Bulqize, Delvine, Devoll, Durres, Elbasan, Cerrik, Patos, Roskovec, Gjirokaster, Libohove, Has, Kavaje, Korce, Kruje, Kucove, Kurbin, Lezhe, Librazhd, Lushnje, Malesi e Madhe, Mallakaster, Mat, Mirdite, Peqin, Pogradec, Shkoder, Tepelene, Memaliaj, Tropoje, Vlore, Kelcyre, Konispol, Vau i Dejes, Selenice, Vore, Kamez, Ura Vajgurore, Maliq, Finiq, Klos			-43,4

18. Analiza e shpenzimeve funksionale

Analiza e shpenzimeve funksionale lejon të shikojme ndryshimet e alokimit të fondeve sipas aktiviteteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Shpenzimet funksionale të vitit 2020 janë krahasuar me ato të vitit 2019 duke konsideruar që ndryshimet ndermjet dy viteve janë rezultat i efekteve të pandemisë.

Në nivel agregat shikohet që fondet janë transferuar nga funksionet ekonomike dhe sociale përfshi në funksionet e rendit dhe të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Fondet nga funksionet e tjera janë zvogëluar duke filluar nga funksioni ekonomik i cili ka rënie në – 27.4%, funksioni i strehimit në – 19.1%, i kulturës në -6.7%, i arsimit në -5%. Ulja më e madhe dhe me efekte sociale është ulja e shpenzimeve sociale në -32.8%.

Grafiku 23: Ndryshimi 2020 - 2019 në % i shpenzimeve funksionale të buxhetit vendor



Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

Tabela 33: Shpenzimet funksionale të buxhetit vendor në miliard lekë dhe ndryshimi 2020 - 2019 në %

	2019	2020	Ne %
Shpenzime te pergjitheshme	12,1	12,0	-0,7
Shpenzimet rendi dhe sigurie	1,4	2,4	66,2
Shpenzime ekonomike	13,4	9,8	-27,4
Shpenzime mbrojtje	1,9	4,0	109,5
Shpenzime strehimi	12,1	9,8	-19,1
Shpenzime shendetesie	0,0	0,0	0,0
Shpenzime kulture	2,5	2,4	-6,7
Shpenzime arsimi	10,8	10,2	-5,0
Shpenzime mbrojtje sociale	2,0	1,4	-32,8
Shpenzimet totale	56,21	51,77	-7,9

Burimi: Ministria e Financave dhe analiza e autorit

19. Konkluzione

Efektet ekonomike në nivel të njësive të vetëqeverisjes vendore u shfaqën me ndërprejen e aktiviteteve të ndërmarrjeve, kryesisht të vogla dhe të mesme, për shkak të bllokimit administrativ si dhe përkeqësimit të treguesve të tyre ekonomik dhe financiar. Goditjen më të madhe nga mbyllja e aktivitetit kanë pësuar ndërmarrjet e vogla të cilat kanë punësuar nga 5 deri në 9 veta. Llogaritet në 986 numri i këtyre ndërmarrjeve të mbyllura në fund të vitit 2020 krahasuar me fundin e vitin 2019. Një efekt tjetër por që nuk është e mundur të matet është mbyllja e përkoheshme e aktivitetit veçanërisht në tremujorin e parë dhe të dytë. Sipas llojit të aktivitetit, ndërmarrjet e akomodimit dhe tregtisë mbeten ndër sektorët më të prekur gjatë pandemisë. Në fund të vitit 2020 ka 727 më pak ndërmarrje aktive të akomodimit dhe shërbimit, ka 656 ndërmarrje më pak në tregti dhe 937 ndërmarrje më pak në sektorin e prodhimit të shërbimeve.

Mbyllja e aktiviteteve shkaktoi uljen e punësimit duke ndikuar drejtëpërdrejtë në situatën financiare të familjeve por dhe në atë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Dalja e personave të papunë ka shtuar presionin për ndihmë tek njësitë e vetëqeverisjes vendore për ushqime, medikamente të mbrojtjes, ndihmë financiare, etj. Mbyllja e kufijve të vendeve për shkak të masave ndikoi në uljen e kërkesës së huaj për sa i përket lëvizjeve si për qëllime të punës apo dhe të turizmit. Numri i netëqëndrimeve në vitin 2020 ra në mbi 50% në krahasim me vitin 2019. Rënia e ditëqëndrimeve është shoqëruar në rënien e mbi 62 % e të ardhurave nga taksa e hotelerisë në vitin 2020. Kjo ndikoi në humbje ekonomike e financiare për operatorët e shërbimeve turistike, të humbjeve të vendeve të punës, si dhe humbje e të ardhurave të bashkive.

Bllokimi administrativ ndikoi dhe në ngadalsimin e aktivitetit të vetë njësive të vetëqeverisjes vendore duke reflektuar në rënien e numrit të lejeve të ndërtimit si dhe ndërprerjen e kontratave me ndërmarrjet e shërbimeve. Rënia e lejeve të ndërtimit në vitin 2020 ka një korelacione me uljen e të ardhurave të mbledhura nga taksat e ndikimit në infrastrukturë. Vlera e investimeve sipas lejeve të ndërtimit është ulur në -5.2% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, ndërsa të ardhurat e mbledhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë kanë një rënie në 5.9% në vitin 2020

Në terma mikroekonomikë rënia e kërkesës dhe e shitjeve si pasojë e tkurrjes e të ardhurave të familjeve solli vështirësi financiare për shumë biznese kryesisht të vogla, si dhe një ndikim negativ në të ardhurat tatimore dhe tarifore për bashkitë. Indeksi i tregtisë me pakicë pati një rënie në -4.3%, ndërsa indeksi i tregtisë së mallrave jo ushqimore në -7.1%. Rënia e indeksit të tregtisë me pakicë si rezultat i rënies së konsumit, ka pasur një efekt negativ të drejtëpërdrejtë në ndërprerjen e aktivitetit të biznesit të vogël, të punësimit por dhe me ndikimin negativ në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe tarifore për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Efektet sociale të pandemisë u shfaqën me rritjen e nivelit të papunësisë si dhe të rritjes së familjeve në ndihmë ekonomike. Numri i të papunëve të regjistruar për herë të parë u rrit nga 5,617 persona në tremujorin e parë të vitit 2020, në 14,867 persona në tremujorin e dytë të vitit 2020. Rritja e numrit të papunëve ishte shumë e lartë për të papunët romë dhe egjiptianë, të atyre përfitues të pagesës së papunësisë dhe të kategorisë përfitues të ndihmës ekonomike. Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike u rrit nga 59 540 familje në fund të vitit 2019, në 60 464 në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe në 63670 në tremujorin e dytë. Ndihma mesatare e përfitimit në muaj për familje u ul ndjeshëm në – 12%. Nga 5,463 lekë në muaj për familje, ndihma mesatare e përfitimit u ul në 4,965 leke.

Situata e krijuar nga pandemia u shoqërua me rritjen e çmimeve të mallrave si ushqimorë dhe atyre të shërbimit mjeksor. Rritja e çmimeve dhe në mënyrë të veçantë e kategorisë së mallrave ushqimorë u nxit nga efekti i masave të marra kundër pandemisë. Rritja më e lartë u reflektua në muajin mars të vitit 2020. Shpenzimet mesatare mujore të shëndetit për familje u rritën në vitin 2020 në 28% krahasuar me vitin 2019. Si pasojë grupet më në nevojë u gjendën në një situatë të rënduar sociale për të përballuar rritjen e kostos së produkteve dhe shërbimeve mjeksore.

Rritja e papunësisë, ulja e të ardhurave, dhe rritja e kostove të produkteve ka rritur hendekun midis grupeve më të cënueshme dhe përkeqësimin social të tyre. Një numër i konsiderueshëm i familjeve mbetën pa mbrojtje duke thelluar më tej nivelin e varfërisë. Grupet sociale më në nevojë do të ushtronin presion mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore për të rritur

shpenzimet si rezultat i rritjes së kërkesës së tyre për mbështetje ekonomike dhe sociale. Njësitë e vetëqeverisjes vendore u vunë përballë një situatë të jashtëzakonshme si për të siguruar funksionimin e masave mbrojtëse në territorin e tyre, por dhe për të siguruar shërbimet sociale si mbështetja shëndetësore, ekonomike e sociale të grupeve në nevojë.

Ndikimi negativ i COVID-19 në financat e njërive të vetëqeverisjes vendore është i dyfishtë si mbi shpenzimet dhe në të ardhurat. Ndryshimet fiskale u lidhën kryesisht me përjashtimet nga taksat e ndryshme të disa kategorive si personat me aftësi të kufizuara, nga ulja e tarifave lokale si ajo e zënies së hapësirës publike për muajt e emergjencës, tarifat e shërbimeve publike si ndriçimi, pastrimi dhe gjelbërimi, uljen e taksës së tokës mbi ndërtesën dhe bujqësinë, shtyrja e pagesave për taksat dhe tarifat vendore. Efekti fiskal i drejtëpërdrejtë për shkak të përkeqësimit të situatës ekonomike si në nivelin qendror por dhe vendor është rishikimi i planifikimit të buxhetit. Bashkitë e rishikuan buxhetin e tyre vendor duke ulur në mënyrë të ndjeshme pritshmërinë e realizimit të të ardhurave të tyre. Ulja e buxhetit vendor krahasuar me buxhetin fillestar është -7.4%.

Masat e ndërmarra me mbylljen e aktiviteteve dhe masat lehtësuese fiskale patën efekte direkt në të ardhurat e veta të bashkive. Tkurrrja e të ardhurave është kryesisht nga ulja e shkallës së mbledhjes së të ardhurave të taksave e tarifave lokale, si dhe në një masë më të ulët nga taksat mbi pronën. Në krahasim me planifikimin e buxhetit niveli mesatar i mbledhjes së të ardhurave të njërive të vetëqeverisjes vendore rezultoi 81.2% ose me një tkurrje në -18.8%. Ndërsa në krahasim me të ardhurat tatimore të mbledhura në vitin 2019, të ardhurat në vitin 2020 janë rreth -5.5 përqind më të ulta se në vitin 2019, ose pothuajse në një nivel me vitin 2018.

Ecuria e të ardhurave të veta të bashkive përcaktohet përgjithësisht nga ecuria e të ardhurave tatimore e tarifore, të cilat përcaktohen kryesisht nga dinamika e taksave lokale. Të ardhurat jo tatimore zënë një peshë relativisht të ulët. Një përqindje të lartë të tkurrjes së të ardhurave të mbledhura krahasuar me planifikimin e buxhetit treguan të ardhurat nga taksat lokale në -22.4%. Të ardhurat nga Taksat mbi pasurinë patën një rënie në -4.3%. Të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar nga biznesi i vogël pati një rritje në 4%. Gjithashtu një tkurrje të lartë patën dhe të ardhurat jo tatimore në -22.4%. Ndërsa krahasuar me vitin 2019 realizimi i të ardhurave është më i ulët në të ardhurat nga taksat lokale në -6.2%, nga taksat mbi pasurinë -1.7%. Të ardhurat nga biznesi i vogël patën një rritje në 5.5%. Gjithashtu të ardhurat jo tatimore treguan një ulje në -4.9%.

Në krahasim me vitin 2019, të ardhurat tatimore dhe tarifore në një masë të konsiderueshme u prekën negativisht nga taksat e ndikimit në infrastrukturë, taksat e pasurisë mbi ndërtesat, taksat e fjetjes në hotel, taksat e tabelës, taksat e përkohëshme e të tjera, nga tarifat e zënies së hapësirës publike dhe tarifa e gjelbërimit. Të gjitha kategoritë e të ardhurave kanë pësuar ulje në vitin 2020 përveç taksës së pastrimit dhe të higjenës që ka treguar një rritje të lehtë në 0.3%. Taksat e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë peshën më të madhe të taksave lokale, ka shënuar një ulje në -5.9%, taksat e tabelës në -3.1%, taksat vendore të përkohëshme në -7.7%, taksat e tjera në -6.2%, tarifat vendore për zënien e hapësirës publike në -20.8%, tarifat e gjelbërimit në -9.1%. Taksat që ka rënie më të lartë është taksat e fjetjes në hotel, e cila ka shënuar një rënie në 96%.

Ndryshimi i të ardhurave të veta në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, është i diferencuar ndërmjet totalit të bashkive në nivel të qarkut. Qarqet me tkurrjen më të lartë të të ardhurave janë qarku i Durrësit, Lezhës, Korçës, Dibërës dhe i Fierit. Qarqet më rritje të të ardhurave të veta janë vetëm i Kukësit dhe i Vlorës. Ndryshimi i të ardhurave të veta të bashkive në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është më shumë i diferencuar ndërmjet vetë bashkive. Numri i bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave është më i lartë se i atyre të cilat kanë rritje të të ardhurave. Përqindja mesatare e uljes së të ardhurave është -19.7%. Të ardhurat tatimore e tarifore janë ulur në 33 bashki me një mesatare të uljes në -20%. Në rreth 43% e bashkive kanë një ulje të të ardhurave tatimore nga -20% deri në mbi -40%. Të ardhurat jo tatimore janë ulur në 32 bashki me një mesatare në -29.1%. Ndërsa janë rreth 25% e bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore në intervalin -20% deri në -40%. Numri i bashkive të cilat kanë ulje të të ardhurave jo tatimore mbi 40% është më i madh se në rastin e të ardhurave tatimore.

Kompensimi i plotë i humbjeve nga të ardhurat tatimore e tarifore në fakt ka ndodhur në raste të pakta përderisa të ardhurat jo tatimore në nivel agregat zënë më pak se 10% të të ardhurave totale të veta. Vetëm në katër raste dhe në bashki të vogla si bashkia e Maliqit, e Pustecit, e Këlcyrës dhe e Tepelenës, humbjet nga të ardhurat tatimore janë kompensur nga rritja e të ardhurave jo tatimore dhe në total të ardhurat e veta janë me rritje në vitin 2020. Ndërsa në dy raste të tjera si në bashkinë e Pogradecit dhe të Devollit, megjithëse të ardhurat tatimore janë në rritje ulja e të ardhurave jo tatimore ka ndikuar që të ardhurat e veta në total të jenë më të ulta se në vitin 2019.

Pavarsisht përdorimit të fondeve të emergjencës, të fondeve të mbartura nga vitet e kaluara (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta), të kontributeve nga qeveria, dhe nga donatorët, burimi total i financimit të bashkive mbetet më i ulët i krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020 totali i burimeve të financimit është 4.6 miliard lekë më i ulët ose -8.2% krahasuar me vitin 2019. Të ardhurat e veta në ulje në -5.6%, financimi i huaj më i ulët në -77.2%, dhe transferta e pakushtëzuar e përdorur mbetet më ulët në -6.7%. Gjithsesi transferta e pakushtëzuar e miratuar në buxhetin vendor të vitit 2020 mbetet e pa përdorur plotësisht. Përveç efektit negativ në nivel agregat dhe vjetor njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë pasur mangësi të likuiditetit gjatë vitit fiskal, në veçanti në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit.

Ecuria e burimeve të financimit mbetet e diferencuar ndërmjet bashkive. Nga analiza rezultojnë se 68% e bashkive në vitin 2020 kanë rezultuar me ulje të burimit të financimit. Rreth 16% e bashkive kanë treguar rritje të transfertës dhe të ardhurave të veta duke pasur një rezultat pozitiv të burimit të financimit. Rreth 10% e bashkive kanë mundur të kompensojnë uljen e të ardhurave të veta nga rritja e përdorimit të transfertës, dhe rreth 7% e bashkive kanë mundur të kompensojnë uljen e përdorimit të transfertës nga rritja e të ardhurave dhe të kenë një rezultat pozitiv të burimit të financimit.

Shpenzimet e njëjësive të vetëqeverisjes vendore në nivel agregat u tkurrën në vitin 2020 në raport me vitin 2019 në rreth 4.6 miliard lekë, ose në -8.1%. Sipas kategorive ekonomike ndryshimi është i diferencuar. Shpenzimet e personelit janë rritur në 2.5%, shpenzimet korente janë ulur në -1.1%. Tkurrjen më të lartë e kanë pasur shpenzimet kapitale në -27.8%. Ecuria

e shpenzimeve kapitale ka përcaktuar dhe dinamikën e shpenzimeve totale. Një efekt me ndikime shtesë ekonomike është dhe rialokimi i shpenzimeve kryesisht kapitale në shpenzime personeli apo operative për të përballuar financimin e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen ndaj pandemisë si dhe mbështetjen e grupeve në nevojë.

Dinamika e shpenzimeve është e diferencuar si në nivel të qarkut për shpenzimet totale dhe sipas kategorive ekonomike. Shpenzimet totale janë ulur në të gjitha qarqet me përjashtim të qarkut të Elbasanit. Shpenzimet kapitale janë ulur në të gjitha qarqet si rezultat kryesisht të rialokimit të tyre në shpenzimet e personelit dhe ato operative. Qarku i Tiranës, i Elbasanit dhe i Korçës kanë rialokuar shpenzimet kapitale në shpenzimet e personelit dhe operative, duke siguruar një rritje pozitive të këtyre kategorive të shpenzimeve. Qarqet e tjera, pavarësisht rialokimit të shpenzimeve kapitale, kanë mundur të plotësojnë pjesërisht nevojat në rritje për shpenzimet e personelit dhe ato operative.

Në nivel të bashkive tkurrja e shpenzimeve në total dhe sipas kategorive të shpenzimeve është më e diferencuar. Janë 24 bashki të cilat kanë treguar ulje të shpenzimeve të personelit dhe 37 të tjera të cilat i kanë rritur shpenzimet e personelit. Janë 32 bashki të cilat kanë ulur shpenzimet korente dhe 29 të cilat i kanë rritur. Janë 43 bashki të cilat i kanë ulur shpenzimet kapitale dhe 18 bashki të cilat i kanë rritur ato. Bashkitë më të mëdha në popullsi si Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Korça, Shkodra dhe Vlora kanë tkurrjen më të madhe, dhe veçanërisht në shpenzimet kapitale duke i alokuar fondet për të mbuluar nevojat për shpenzime shtesë të personelit dhe ato operative.

Mungesa e fondeve të mjaftueshme për të plotësuar kryesisht nevojat ndaj masave të mbrojtjes është reflektuar në rialokimin ndërmjet funksioneve. Në nivel agregat fondet janë transferuar nga funksionet ekonomike dhe sociale, në funksionet e rendit, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. Në krahasim me vitin 2019, në vitin 2020 shpenzimet sipas funksionit ekonomik kanë rënie në - 27.4%, sipas funksionit të strehimit në - 19.1%, të kulturës në - 6.7%, të arsimit në -5%. Ulja më e madhe dhe me efekte sociale është ulja e shpenzimeve sipas funksionit social në -32.8%.

20. ANEKSI 1 - Të ardhurat totale në nivel të bashkive

Qarku i Tiranës

Në analizën në nivel të bashkive për Qarkun e Tiranës, përsa i përket burimeve të financimit, janë konsideruar të ardhurat që vijnë nga transfertat e pakushtëzuar si dhe të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore. Burimet e financimit si për transfertën e pakushtëzuar të përdorur dhe të ardhurave të veta të bashkive janë zvogëluar për të gjitha bashkitë, përjashtimisht bashkisë së Rrogozhinës. Transfertat e pakushtëzuar nga qeveria qendrore është zvogëluar jo në mënyrë të njëtrajtëshme ndërmjet bashkive. Bashkia e Vorës dhe e Tiranës kanë një zvogëlim të transfertës në nivelin e -18.8% dhe 18.6%.

Të ardhurat e veta të bashkive kanë treguar rënie krahasuar me vitin 2019. Më e lartë kjo rënie është në bashkinë e Kamzës në -37.4%, të Vorës në -28.7%, të Kavajës në -21.7%. Ndërsa bashkia e Tiranës dhe e Rrogozhinës kanë shënuar rritje. Për bashkinë e Tiranës rritja është e pandjeshme në +0.04%. Ndërsa bashkia e Rrogozhinës ka shënuar rritje të të ardhurave të veta në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 në +24.8%.

Të ardhurat nga transfertat dhe të ardhurat e veta në milion lekë

	Transfertat e pakushtëzuar			Të ardhurat e veta në vitin ushtrues		
	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Tirana	4019,8	3270,8	-18,6	13882,9	13888,8	0,04
Kamza	749,5	665,6	-11,2	783,8	490,8	-37,4
Kavaja	396,7	359,0	-9,5	386,2	302,5	-21,7
Rrogozhina	215,7	339,4	57,3	93,0	116,1	24,8
Vora	193,2	156,9	-18,8	388,7	277,2	-28,7
K. i Qarkut	93,5	93,1	-0,4	0,3	0,3	-18,2

Të ardhurat e veta të bashkive

Të ardhurat tatimore kanë pësuar rënie duke përjashtuar bashkinë e Tiranës dhe të Rrogozhinës, të cilat kanë një rritje respektivisht në 1.1% dhe në 10.1%. Bashkitë të cilat kanë pasur një rënie të ndjeshme të të ardhurave të veta janë bashkia e Kamzës me një ulje të të ardhurave në -37.3%, e Vorës në -28.8%, e Kavajës -22.9%. Të ardhurat jo tatimore në të gjitha bashkitë kanë pësuar rënie me përjashtim të bashkisë së Rrogozhinës, e cila ka shënuar një rritje në 16%. Bashkia e Kamzës ka shënuar një ulje të të ardhurave jo tatimore në -41.4%, e ndjekur nga bashkia e Vorës në -23.5%, e Tiranës në -10.7% dhe e Kavajës në -1.8%.

Të ardhurat e veta të bashkive në milion lekë

	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat			Të ardhurat jo tatimore		
	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Tirana	12668,1	12803,5	1,1	1214,9	1085,3	-10,67
Kamza	762,3	478,2	-37,3	21,5	12,6	-41,4
Kavaja	364,3	281,0	-22,9	21,9	21,5	-1,8
Rrogozhina	89,8	98,9	10,1	2,5	2,9	16,0
Vora	380,6	271,0	-28,8	8,1	6,2	-23,5

Të ardhurat tatimore nga taksat dhe tarifat

Të ardhurat nga pasuria kanë shënuar rritje pothuajse uniforme për të gjitha bashkitë, me përjashtim të bashkisë së Kavajës e cila ka një ulje të të ardhurave nga pasuria në -1.6%. Ndërsa për bashkitë e tjera rritja e të ardhurave varion nga +3.1% në bashkinë e Kamzës në +7.0% në bashkinë e Vorës. Taksat lokale kanë pësuar ulje me përjashtim të bashkisë së Rrogozhinës e cila ka rritje të të ardhurave në +16.6%.

Uljen më të lartë e ka shënuar bashkia e Vorës në -46.7% dhe e Kamzës në -42.6%. Ndërsa për bashkinë e Tiranës, ulja është papërfillshme në -0.1%. Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël kanë treguar rritje, me përjashtim të bashkisë së Rrogozhinës e cila ka shënuar një rënie në -34.9% të të ardhurave.

Të ardhurat tatimore nga taksat dhe tarifat në milion lekë

	Taksa mbi pasurine e paluajtshme			Taksat lokale			Taksa e Biznesit të vogël		
	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Tirana	2242,2	2356,1	5,1	10244,3	10234,8	-0,1	181,6	212,7	17,1
Kamza	77,1	79,5	3,1	679,2	390,1	-42,6	5,9	8,6	45,8
Kavaja	79,7	78,4	-1,6	280,7	197,1	-29,8	3,9	5,5	41,0
Rrogozhina	33,7	35,6	5,6	51,8	60,4	16,6	4,3	2,8	-34,9
Vora	133,6	142,9	7,0	243,9	129,9	-46,7	3,0	3,2	6,7

Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme

Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat kanë treguar rritje në të gjitha bashkitë për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Dhe taksa mbi tokën bujqësore ka shënuar rritje, përjashtimisht për bashkinë e Kamzës që ka një ulje në 25.5% në vitin 2020. Kategoria e të ardhurave nga taksat mbi pasurinë nuk ka reflektuar ndonjë ndikim nga efekti i pandemisë.

Të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme në milion lekë

	Ndërtesë			Tokë bujqesore			Trualli		
	2019	2020	Ne %	2019	2020	Ne %	2019	2020	Ne %
Tirana	1837,8	1918,7	4,4	21,6	21,9	1,4	56,4	212,7	277,1
Kamza	66,7	72,8	9,1	4,7	3,5	-25,5	17,0	-	-
Kavaja	57,7	58,7	1,7	13,8	15,1	9,4	-	-	-
Rrogozhin	14,9	15,7	5,4	18,0	19,8	10,0	-	-	-
Vora	105,9	107,2	1,2	5,4	7,0	29,6	14,6	3,2	-78,1

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat lokale

Të ardhurat nga taksat lokale

Në të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë kanë treguar një ulje të ndjeshme për bashkinë e Vorës, të Kavajës dhe të Kamzës. Respektivisht të ardhurat janë ulur në -68%, në -48% dhe -21%. Ndërsa bashkia e Tiranës dhe e Rrogozhinës kanë shënuar rritje të të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, respektivisht +2% dhe +78%.

Taksa e fjetjes në të gjitha bashkitë përjashtimisht për bashkinë e Kamzës, tregoi një rënie të lartë të të ardhurave lokale. Vora ka pësuar një ulje në -96% të të ardhurave, Tirana -68%, Kavaja -43% dhe Rrogozhina në -23%. Taksa e tabelës ka treguar një ulje të lartë në bashkinë e Vorës në -70%. Për bashkinë e Tiranës dhe Kamzës ulje e të ardhurave është më e moderuar respektivisht -10% dhe -20%.

Ndërsa bashkia e Kavajës dhe Rrogozhinës kanë patur rritje të të ardhurave nga taksa e tabelës. Bashkia e Kavajës 3%, ndërsa bashkia e Rrogozhinës një rritje të lartë në 75%. Taksat e tjera kanë shënuar ulje përjashtimisht për bashkinë e Rrogozhinës dhe e Kavajës, të cilat kanë një rritje të të ardhurave në 14% dhe +3%. Tirana dhe Kamza kanë pësuar ulje të të ardhurave. Bashkia e Kamzës ka shënuar një ulje të konsiderueshme të të ardhurave në 72%. Ndërsa bashkia e Tiranës ka pësuar ulje në -5%.

Të ardhurat nga taksat lokale në milion lekë

	Taksa e ndikimit në infrastrukturë			Taksa e fjetjes ne hotel			Taksa e tabelës			Taksa të tjera		
	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Tirana	6228	6379	2	115	37	-68	263	237	-10	1464	1396	-5
Kamza	191	152	-21	0	0	100	0	0	-20	375	106	-72
Kavaja	169	88	-48	8	4	-44	1	1	3	41	42	3
Rrogozhinë	7	13	78	4	3	-23	1	1	75	19	22	14
Vora	179	57	-68	1	0	-96	0	0	-70	20	20	0

Të ardhurat nga tarifat lokale

Të ardhurat nga tarifa e zënies së hapësirës publike kanë pësuar ulje në të gjitha bashkitë, përjashtimisht për bashkinë e Rogozhinës e cila ka një rritje të të ardhurave, dhe e Vorës që nuk ka rritje të të ardhurave. Ndërsa të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe higjenës janë rritur për të gjitha bashkitë. Gjithashtu në bashkinë e Kamzës dhe të Rogozhinës të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit kanë treguar rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

Të ardhurat nga tarifat lokale në milion lekë

	Tarifa e zënies së hapësirës publike			Tarifa e pastrimit dhe higjenës			Tarifa e gjelbërimit		
	2019	2020	Ne %	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Tirana	387,2	22,7	-94,1	1787,5	1958,4	9,6	-	-	-
Kamza	0,01	0,00	-60,0	96,4	112,8	17,0	16,5	19,2	16,4
Kavaja	32,7	28,2	-13,8	29,5	33,6	13,9	-	-	-
Rogozhinë	17,5	18,1	3,4	0,3	0,4	29,6	2,5	2,6	4,0
Vora	0,0	0,0	0,0	43,3	47,4	9,5	-	-	-

Qarku i Beratit

Në analizën në nivel të bashkive për Qarkun e Beratit, burimet e financimit për transfertën e pakushtëzuar të përdorur dhe të ardhurave të veta janë zvogëluar për bashkinë e Kuçovës. Ndërsa për bashkitë e Beratit dhe Poliçanit është zvogëluar përdorimi i transfertës por janë rritur të ardhurat e veta. Ndërsa për bashkitë e Skraparit dhe të Urës Vajgurore është rritur si përdorimi i transfertës por dhe të ardhurat e veta. Të ardhurat e veta të bashkive kanë treguar rritje krahasuar me vitin 2019 për bashkitë e Beratit, të Poliçanit dhe të Urës Vajgurore. Rënie të lartë të të ardhurave të veta kanë treguar në bashkinë e Skraparit në -37.4%, dhe të Kuçovës në -22.5%.

Të ardhurat nga transfertat dhe të ardhurat e veta në milion lekë

	Transferta e pakushtëzuar			Të ardhurat e veta në vitin ushtrues		
	2019	2020	Në %	2019	2020	Në %
Berat	609,1	507,1	-16,7	279,4	290,7	4,0
Poliçan	154,4	153,3	-0,7	26,8	30,4	13,4
Skrapar	200,8	272,0	35,5	69,8	43,7	-37,4
Kuçovë	281,8	259,1	-8,1	122,6	95,0	-22,5
Urë Vajgurore	206,3	222,1	7,7	117,6	125,9	7,1
K. i Qarkut	28,7	27,9	-2,8	0,4	0,2	-50,0

Të ardhurat e veta të bashkive

